



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 79

Tiranë – E enjte, 30 maj 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 27/2019 datë 8.5.2019	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10 107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 5951
Dekret i Presidentit nr. 11190, datë 28.5.2019	Për shpallje ligji..... 5957
Ligj nr. 28/2019 datë 8.5.2019	Për një shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar..... 5957
Dekret i Presidentit nr. 11191, datë 28.5.2019	Për shpallje ligji..... 5957
Dekret i Presidentit nr. 11189, datë 22.5.2019	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 5957
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 10, datë 15.5.2019	Për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit në programet e ciklit të parë të studimeve, në programet e studimeve me karakter profesional, si dhe në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve, në institucionet e arsimit të lartë..... 5958
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 13, datë 22.5.2019	Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit “Mësues për Shqipërinë” 5968
Urdhër i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 175, datë 14.5.2019	Për shpalljen e disa ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 3 “Instrumentet financiare”, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale”, Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 11 “Tatimi mbi fitimin” dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 13 “Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare”, të përmirësuara”..... 5978

Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 7479, datë 21.5.2019	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje me Kosovën.....	5990
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 7494, datë 21.5.2019	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje me Kosovën.....	5990
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 7578, datë 23.5.2019	Për hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje me Francën.....	5990
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 68, datë 10.5.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e draftkontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a., për periudhën 1.3.2019–31.12.2019.....	5990
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 69, datë 10.5.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.....	5993
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 70, datë 10.5.2019	Mbi fillimin e procedurës, për modifikimin e licencës së shoqërisë HENZ ENERGY sh.p.k., nr. 158, seria PV12K, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 65, datë 28.5.2012, për licencimin e shoqërisë HENZ ENERGY sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3”.....	5994
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 71, datë 10.5.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Power and Gas Operations” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike....	5995
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 72, datë 10.5.2019	Mbi licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën Sheq Marinas, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier.....	5996
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 74, datë 10.5.2019	Mbi miratimin e “Marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe Kastrati Energy sh.p.k.....	5998
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 75, datë 10.5.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin prill 2019.....	5999
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetases Farije Tafa.....	6001
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilir Gosa.....	6001
	Vendim (<i>i shkurtuar</i>) për heqjen e zotësisë juridike për të vepruar të shtetasit Byrhan Katana.....	6001
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Rajmonda Tota.....	6001



LIGJ
Nr. 2/2019

**PËR LISIN E RYSHIMEVE SHËNDETËSORE
E LIGJIT NR. 10/2009, ATË 30.3.2009,
3 NENET 1, 2, 3
1 NENET 3, 1, 3, 4, 5
TË RYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10/107, datë 30.3.2009, "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 3 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në pikën 1 dhe në të gjithë përmbajtjen e ligjit, emërtimi "Ministria/ministri i Shëndetësisë" zëvendësohet me fjalët "ministra/ministri përgjegjës për shëndetësinë".

2. Pas pikës 12 shtohen pikat 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19 me këtë përmbajtje:

"13. "Informacioni shëndetësor" është çdo e dhënë e dokumentuar e historikut të gjendjes shëndetësore të personit dhe përfshin simptomën, diagnozën, vlerësimin, kujdesin, progresin dhe rezultatin shëndetësor për çdo marrëdhënie me shërbimin shëndetësor. Informacioni shëndetësor mund të jetë në formë elektronike, në letër ose në të dyja formatet.

14. "Sistemi i informacionit shëndetësor" është një sistem, i cili mbledh, ruan, menaxhon dhe/ose shkëmben në mënyrë të sigurt informacion në lidhje me shëndetin e personit, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së ofrimit të kujdesit shëndetësor ndaj çdo personi.

15. "Audit klinik" është auditimi i praktikës mjekësore, sipas protokolleve klinike dhe udhërrëfyesve të kujdesit shëndetësor, bazuar në

fakte, si dhe analiza sistematike e përdorur nga profesionistët e shëndetësisë për të vlerësuar dhe përmirësuar kujdesin ndaj pacientëve, duke përfshirë procedurat e përdorura për diagnostikim e trajtim.

16. "Portali infermier për Shqipërinë" është një platformë online ku kandidatët për profesionistë shëndetësorë, anëtarë të Urdhrit të Infermierit regjistrohen për të marrë pjesë në konkurrimin për një pozicion pune në institucionet publike të kujdesit shëndetësor.

17. "Akreditimi" është procesi i pavarur për vlerësimin e jashtëm të cilësisë, i cili përcakton nëse institucioni i kujdesit shëndetësor përmbush standardet, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

18. "Protokolli mjekësor" është një dokument që përcakton proceset që ndiqen për diagnozën, menaxhimin dhe trajtimin e përfituesve të kujdesit shëndetësor.

19. "Udhërrëfyesi klinik" është një dokument që ka për qëllim orientimin në përcaktimin e kriterëve dhe marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me diagnozën, menaxhimin dhe trajtimin e përfituesve të kujdesit shëndetësor."

Neni 2

Në nenin 4, pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

"9. Ministri përgjegjës për shëndetësinë harton politikat dhe përcakton standardet për licencimin dhe kontrollin e institucioneve të kujdesit shëndetësor."

Neni 3

Në nenin 5, pikat 2 dhe 3, fjalët "bashkitë dhe komonat" zëvendësohen me fjalët "bashkitë dhe qarqet".

Neni 4

Pas nenit 6 shtohen nenet 6/1 dhe 6/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 6/1

Këmbëtar i Shëndetësisë

1. Këshilli Kombëtar i Shëndetësisë (KKSH) është organ këshillimor për politikat e zhvillimit



të sistemit shëndetësor, pranë ministrit përgjegjës për shëndetësinë, dhe përbëhet nga profesionistë të nënfushave të ndryshme të shëndetësisë.

2. KKSH-ja mbledhet me kërkesë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe jep mendime për:

a) hartimin e strategjive dhe programeve kombëtare në fushën e shëndetësisë

b) përcaktimin e politikave prioritare shëndetësore

c) përmirësime legjislative që ndikojnë në zhvillimin e politikave shëndetësore dhe përafrimin e tyre me ato europiane

ç) çështje të tjera të politikave shëndetësore.

3. Përbërja, organizimi, funksionimi dhe drejtimi i KKSH-së përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 6/2

Këshilli Kombëtar i Pacientëve

1. Këshilli Kombëtar i Pacientëve është organ këshillimor i ministrit përgjegjës për shëndetësinë, i cili përfaqëson interesat e pacientëve dhe në përbërje të tij ka përfaqësues të shoqatave të pacientëve dhe/ose organizatave jofitimprurëse, përfaqësues të pacientëve.

2. Përbërja, organizimi dhe funksionimi i Këshillit Kombëtar të Pacientëve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 5

Në nenin 7, pika 2, fjala “spitali” zëvendësohet me fjalët “institucioni i kujdesit shëndetësor”.

Neni 6

Në nenin 9 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kujdesi shëndetësor parësor organizohet në mënyrë të tillë që çdo person, me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, të ketë mundësinë të përdorë ofruesit e kujdesit shëndetësor parësor, të drejtën të zgjedhë dhe të regjistrohet pranë mjekut të familjes të ofruesit të kujdesit shëndetësor parësor.”

2. Në fund të pikës 3 shtohen fjalët “sipas standardeve dhe udhërrëfyese të miratuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.”

Neni 7

Në nenin 11, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Rregullat e organizimit, të funksionimit për shërbimin e urgjencës mjekësore rregullohen me ligj të veçantë.”

Neni 8

Në nenin 15, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Rregullat e organizimit, të funksionimit për kujdesin paliativ rregullohen me ligj të veçantë.”

Neni 9

Në nenin 17, pika 2, emërtimi “Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” zëvendësohet me fjalët “ministria përgjegjëse për sigurinë në punë”.

Neni 10

Në nenin 22, pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

“4. Të gjitha institucionet e kujdesit shëndetësor, pas licencimit të veprimtarisë, i nënshtrohen procesit të vlerësimit të përbushjes së standardeve bazë të cilësisë për akreditim, të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Pas plotësimit të standardeve bazë të cilësisë për akreditim, institucioni i kujdesit shëndetësor vijon procesin e akreditimit. Në rast të mospërbushjes së standardeve bazë të cilësisë për akreditim, institucionit të kujdesit shëndetësor i pezullohet licenca. Nëse edhe pas përfundimit të periudhës së pezullimit institucioni i kujdesit shëndetësor nuk ka përbushur standardet bazë të cilësisë për akreditim, ministri përgjegjës për shëndetësinë vendos revokimin e licencës për ushtrimin e veprimtarisë. Procedura për pezullimin dhe revokimin e licencës së veprimtarisë, si dhe afatet përkatëse përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.”



Neni 11

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24

Mbikëqyrja e brendshme dhe inspektimi

1. Mbikëqyrja e brendshme organizohet dhe drejtohet nga drejtuesit e institucioneve të kujdesit shëndetësor, në zbatim të rregullave të brendshme organizative, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

2. Çdo institucion i kujdesit shëndetësor harton dhe miraton rregulloren e brendshme të funksionimit, bazuar në legjislacionin në fuqi.

3. Inspektimi i përmbushjes së kërkesave ligjore të parashikuara në këtë ligj, i institucioneve të kujdesit shëndetësor, kryhet nga institucioni përgjegjës që mbulon inspektimin e fushës së shëndetësisë, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 12

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Auditimi i klinikut

1. Auditimi klinik realizohet me kërkesë të ministrit përgjegjës për shëndetësinë ose të vetë institucionit të kujdesit shëndetësor, me qëllim evidentimin, zbatimin e protokolleve, udhërrëfyesve dhe vlerësimin e procedurave të ndjekura nga institucioni i kujdesit shëndetësor.

2. Çdo institucion i kujdesit shëndetësor, publik ose privat, duhet të zbatojë protokollin dhe udhërrëfyesin, të miratuar nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

3. Auditimi klinik kryhet nga auditues vendas ose të huaj, të njohur nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë. Mënyra e njohjes së audituesve klinikë përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë shpall çdo vit listën e audituesve të njohur prej saj.

4. Mënyra e kryerjes së procesit të auditimit klinik dhe tarifat e pagesës së audituesve përcaktohen me vendim të Këshillit të

Ministrave. Përzgjedhja e audituesve klinikë nga lista e audituesve, për kryerjen e procesit të auditimit klinik, bëhet nga struktura përkatëse e përcaktuar nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.”.

5. Rekomandimet e evidentuara nga audituesit klinikë në institucionin e kujdesit shëndetësor, të cilat kanë për qëllim përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit, zbatohen nga institucioni i kujdesit shëndetësor.”.

Neni 13

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Akreditimi

1. Institucionet e kujdesit shëndetësor i nënshtrohen procesit të akreditimit, i cili kryhet nga institucioni përgjegjës për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor. Përrjashtim nga ky rregull bëjnë laboratorët mjekësorë.

2. Në kuptim të këtij ligji, akreditimi është proces i certifikimit të cilësisë së institucionit shëndetësor nëpërmjet vlerësimit të jashtëm të cilësisë, në përputhje me standardet e cilësisë për akreditim, të miratuara nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë.

3. Standardet e cilësisë për akreditim hartohen nga institucioni përgjegjës për akreditimin dhe ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

4. Standardet e cilësisë për akreditim shëndetësor ndahen në standardet bazë të cilësisë, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga institucionet e kujdesit shëndetësor, dhe standardet optimale, të cilat shërbejnë për akreditimin e institucionit.

5. Vendimi për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor jepet nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, pas rekomandimit të Bordit të Akreditimit.

6. Mënyra e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor, tarifat për procesin e akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor, publik dhe jopublik, dhe afatet për procesin e akreditimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.



Neni 14

Në nenin 27, pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Pezullimi dhe revokimi i licencave të institucioneve të kujdesit shëndetësor jopublik, që ofrojnë veprimtari në fushën e shëndetësisë, kryhen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë. Në rast se konstatohen shkelje të kriterëve të licencimit, sipas legjislacionit në fuqi për këtë qëllim, ministria përgjegjëse për shëndetësinë revokon licencën e institucionit të kujdesit shëndetësor jopublik, në çdo kohë. Vendimi i ministrit përgjegjës për shëndetësinë, për pezullimin dhe revokimin e licencës së institucionit të kujdesit shëndetësor jopublik, publikohet nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve. Në rast se institucioni i kujdesit shëndetësor jopublik ndërpret veprimtarinë me iniciativën e tij, atëherë paraqet kërkesë në Qendrën Kombëtare të Biznesit për revokimin vullnetar të licencës.”.

Neni 15

Neni 30 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 30

Sistemi i informacionit shëndetësor

1. Sistemi elektronik i integruar i informacionit shëndetësor përbëhet nga regjistra të caktuar dhe dosja vetjake shëndetësore e individit, bazuar në standardet më të mira ndërkombëtare të informacionit shëndetësor. Mënyra e administrimit të sistemit elektronik të integruar të informacionit shëndetësor përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Të dhënat shëndetësore bazohen në grumbullimin, ruajtjen dhe evidentimin në regjistra, në format elektronik ose në letër.

3. Të gjitha institucionet, publike ose jopublike, që krijojnë, ruajnë dhe/ose përpunojnë të dhëna shëndetësore, në format elektronik ose në letër, janë të detyruara t'i ofrojnë ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë akses në këto të dhëna, duke respektuar legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit shëndetësor. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit

shëndetësor, publikë ose jopublikë, janë të detyruar të mbledhin, të raportojnë dhe të shkëmbejnë të dhëna, sipas mënyrës dhe formatit që përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, publikë ose jopublikë, mundësojnë përshtatshmërinë e sistemit të tyre të informacionit shëndetësor dhe krijojnë infrastrukturën e nevojshme për shkëmbimin e të dhënave dhe dokumenteve mjekësore elektronike me sistemin e regjistrave elektronikë të shëndetit. Ministri përgjegjës për shëndetësinë përcakton me urdhër formatin dhe përmbajtjen e regjistrave shëndetësorë, përfshirë mënyrën e administrimit të tyre, formatin dhe përmbajtjen e dokumentacionit shëndetësor e formatin, si edhe përbërjen e dosjes vetjake të shëndetit.

5. Profesionistët e shëndetit dhe përdoruesit e sistemeve të informacionit shëndetësor, në të gjitha institucionet e ofrimit të kujdesit shëndetësor, janë përgjegjës për cilësinë dhe saktësinë e të dhënave të regjistruara, në format elektronik ose në letër, si dhe për ruajtjen e konfidencialitetit të të dhënave, sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale.

6. Institucionet e ofrimit të kujdesit shëndetësor, publike ose jopublike, janë përgjegjëse për zbatimin e standardeve më të mira ndërkombëtare për administrimin, sigurinë, ruajtjen dhe shkëmbimin e të dhënave dhe dokumenteve mjekësore.”.

Neni 16

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31

Praktikat e shëndetit

1. Profesionistët e shëndetësisë ushtrojnë profesionin e tyre në të gjitha strukturat shëndetësore ku ofrohet kujdes shëndetësor, publik ose jopublik, sipas standardeve profesionale dhe etike të shërbimit të kujdesit shëndetësor, të miratuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

2. Profesionistët e shëndetësisë, të cilët kanë përfituar më shumë se një profesion në fushën e shëndetësisë, nuk mund t'i ushtrojnë njëkohësisht këto profesione, kur këto u përjasin dy urdhrave të ndryshëm profesionalë. Këta



profesionistë deklarojnë profesionin që duan të zgjedhin pranë urdhrave profesionalë përkatës, duke pezulluar në këtë mënyrë të drejtën e ushtrimit të profesionit/profesioneve që u përkasin urdhrave të tjerë.”.

Neni 17

Pas nenit 31 shtohet neni 31/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 31/1

Pranimi në institucionet e kujdesit të shëndetësor të rregullimit të shëndetësor

1. Profesionistët e shëndetësisë prahen në institucionet e kujdesit shëndetësor publik bazuar në parimet e meritës, të konkurrimit të hapur dhe të transparencës.

2. Profesionistët e shëndetësisë prahen në institucionet e kujdesit shëndetësor publik bazuar në kriteret dhe procedurat e konkurrimit, të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë.

3. Profesionistët e shëndetësisë, anëtarë të Urdhrit të Infermierit, të cilët e ushtrojnë profesionin e tyre në institucionet e kujdesit shëndetësor publik, emërohen sipas renditjes në portalin “Infermier për Shqipërinë”. Procedurat e rekrutimit, shpalljes për konkurrim, renditjes së kandidatëve, procedura e pranimit dhe e emërimit nëpërmjet portalit “Infermier për Shqipërinë” përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për shëndetësinë dhe kryhen nga institucioni përgjegjës për këtë qëllim.

4. Drejtuesit e institucioneve të kujdesit shëndetësor publik emërohen nga ministri përgjegjës për shëndetësinë, sipas procedurës së përcaktuar me urdhër të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Drejtuesi i emëruar i institucionit të kujdesit shëndetësor është i detyruar të kryejë trajnimin e detyrueshëm për drejtim dhe administrim të institucionit të kujdesit shëndetësor nga institucioni përkatës, i ngarkuar për këtë qëllim nga ministri përgjegjës për shëndetësinë.”.

Neni 18

Neni 33 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33

Edikimi i vazhdueshëm rregullor

1. Ministria përgjegjëse për shëndetësinë krijon program të detyrueshëm për edukimin e vazhdueshëm profesional, i quajtur “Programi i Certifikimit për Profesionistët e Shëndetësisë”. Profesionistët duhet të mbledhin një numër të caktuar kreditesh të edukimit të vazhdueshëm profesional, sipas procedurave dhe kriterëve të miratuara nga Këshilli i Ministrave. Certifikimi është procesi që profesionisti i shëndetësisë përfundon me përbushjen e kriterëve të programit të certifikimit, i cili përputhet me afatet kohore të licencimit.

2. Profesionistët e kujdesit shëndetësor janë të detyruar që t’i nënshtrohen edukimit të vazhdueshëm, për të përditësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre, në mënyrë që të përmirësojnë cilësinë e kujdesit shëndetësor.

3. Profesionistit të shëndetësisë, që nuk përbush kriteret e programit të certifikimit, i pezullohet/ndërpritet kontrata me institucionin shëndetësor dhe nuk i rinovohet leja e ushtrimit të profesionit nga urdhri profesional përkatës. Rifitimi i lejes së ushtrimit të profesionit bëhet vetëm pasi profesionisti i nënshtrohet provimit të certifikimit.

4. Provimi i certifikimit zhvillohet nga komisionet e provimit të certifikimit, të ngritura pranë strukturave të përcaktuara nga ministri përgjegjës për shëndetësinë për organizimin e provimit të certifikimit. Tarifat e provimit të certifikimit janë të njëjta me ato të provimit të shtetit dhe të ardhurat nga provimet e certifikimit i kalojnë strukturës përkatëse që zhvillon provimin e certifikimit.

5. Institucionet e kujdesit shëndetësor duhet të lehtësojnë edukimin e vazhdueshëm të profesionistëve të tyre. Ato janë të detyruara të hartojnë dhe të zbatojnë programe të akredituara të edukimit të vazhdueshëm për profesionistët e tyre.

6. Në rast se profesionistët e punësuar në institucionet publike të kujdesit shëndetësor nuk përbushin kërkesat e programit të certifikimit,



për drejtuesit e tyre merren masa disiplinore deri në lirim nga detyra.”

Neni 19

Në nenin 33/1, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ofrues të aktiviteteve të edukimit të vazhdueshëm janë të gjitha strukturat, publike ose jopublike, akademike ose joakademike, fitimprurëse ose jofitimprurëse, të vendit ose të huaja, të cilat janë të regjistruara për ushtrim aktiviteti në Republikën e Shqipërisë, sipas kritereve të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”

Neni 20

Në nenin 33/2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në të gjithë përmbajtjen e nenit:

a) emërtimi “Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim” zëvendësohet me fjalët “institucioni përgjegjës për edukimin në vazhdim”;

b) emërtimi “Qendra Kombëtare e Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit të Institucioneve Shëndetësore” zëvendësohet me fjalët “institucioni përgjegjës për akreditimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor”.

2. Në pikën 1, pas shkronjës “e” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) përfaqësuesi jurist i ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë.”

3. Në pikën 2 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) miraton tarifat e akreditimit të aktiviteteve dhe të ofruesve të edukimit të vazhdueshëm.”

b) Pas shkronjës “e” shtohet shkronja “ë” me këtë përmbajtje:

“ë) miraton fushat prioritare të edukimit të vazhdueshëm për kategoritë e ndryshme të profesionistëve të shëndetësisë.”

Neni 21

Në nenin 38 bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Në shkronjën “a”, përcaktimi “në nenet 21 e 22” zëvendësohet me përcaktimin “në nenet 21 e 22, pikat 1, 2, 3”.

2. Në shkronjën “b”, përcaktimi “sipas neneve 23, 24 e 25” zëvendësohet me përcaktimin “sipas neneve 23 dhe 24”.

3. Shkronja “ç” ndryshohet si më poshtë:

“ç) mospërmbushja e detyrimeve të parashikuara në pikën 5, të nenit 30, nga ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor dënohet me gjobë në masën 200 000 (dyqind mijë) lekë” dhe në raste të përsëritura me heqje licence për ofruesit e shërbimeve të kujdesit shëndetësor jopublik.”

4. Pas shkronjës “ç” shtohet shkronja “d” me këtë përmbajtje:

“d) shkelja e pikës 5, të nenit 33, nga drejtuesit e institucioneve publike të kujdesit shëndetësor dënohet me gjobë në masën nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë deri 100 000 (njëqind mijë) lekë.”

Neni 22

Ngarkohet Këshilli i Ministrave dhe ministri përgjegjës për shëndetësinë që, brenda 9 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 23

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të nenit 12 dhe nenit 15, pika 5, të këtij ligji, të cilët hyjnë në fuqi më 1 janar 2020.

Miratuar në datën 8.5.2019.

Shtatori me detyrën nr. 11190, datë 2 shtatori 2019 të Prezidentit të Republikës së Shqipërisë, Ilir Meta



EKRET

r 11190, datë 2019

PËR SHPALLJE LIQI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 27/2019 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

SHQIPËRISË

Iir Meta

LIQI

r 2019

PËR JË SHITESË Ë LIQI R3,

, 2 , 2
, 3 , 3 ,

TË RYSHUAR

Në mbështetje të neneve 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e deputetit Pjerin Ndreu,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet shtesa si më poshtë:

Në nenin 127, pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3.1 Pezullimi i lejedrejtimit të lëshuar nga një shtet i huaj, në rastet kur kundërvajtësi jep pëlqimin, konvertohet me pagesën e një shume që është sa dyfishi i masës administrative maksimale të parashikuar për normën e shkelur.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 8.5.2019.

Sa me dretin nr 11191, datë 2019 të Preidentit të Re i ë S i ëri ë, Iir Meta

EKRET

r 11191, datë 2019

PËR SHPALLJE LIQI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1 dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 28/2019 “Për një shtesë në ligjin nr. 8378, datë 22.7.1998, “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS

SHQIPËRISË

Iir Meta

EKRET

r 1119, datë 22019

PËR LEJIMI E LË IES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 15 e 20, të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, bazuar edhe në propozimet e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Klevis Albert Mihali
2. Sindi Hysen Zeneli
3. Adnand Reis Alikaj



4. Edrin Halil Lalaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SHQIPËRISË
Ilir Meta

UË HËZIM
në datë 10 shtator 2019

PËR PROÇESIN E URAT E APLIKIMIT DHE TË REGJISTRIMIT DHE TË PORTALET TË PARË TË STUDIUMIT, DHE TË REGJISTRIMIT E STUDIUMIT ME KARAKTER PROFESIONAL, SI DHE TË REGJISTRIMIT DHE TË PORTALET TË TË STUDIUMIT, DHE TË REGJISTRIMIT E ARSIMIT TË LARTË

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të ligjit nr. 80/2015, datë 22.7.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZUJ:

KREU I
PORTALET E APLIKIMIT DHE TË
REGJISTRIMIT

1. Portali matura shtetërore është sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të administrojë:

a) procedurat e aplikimit me formularët A1 dhe A1Z të maturantëve/kandidatëve të maturës shtetërore

b) digjitalizimin e rezultateve të këtyre provimeve

c) prodhimin e diplomës së maturës shtetërore.

2. Portali maturanti është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë:

a) procesin e regjistrimit dhe administrimit të rezultateve të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë të maturantëve/kandidatëve, që kanë plotësuar formularin e aplikimit A1 ose A1Z në portalin matura shtetërore

b) ndërveprimin me portalin U-Albania nëpërmjet përcjelljes në RASH të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve aplikues me formularët A1/A1Z

c) prodhimin e certifikatës së maturës shtetërore.

3. Portali U-Albania është një sistem elektronik bazë të dhënash, i cili do të kryejë procedurat e mëposhtme:

a) informimin e maturantëve/kandidatëve për programet e studimit që ofrojnë IAL-të publike dhe jopublike për çdo vit akademik dhe për çdo program, në mënyrë të detajuar:

- kriteret e pranimit
- kuotat e pranimit
- programet mësimore, kurrikulat etj.

b) procesin e përzgjedhjes nga maturantët/kandidatët të preferencave në programet e studimit të ciklit të parë të studimeve dhe/ose programeve të studimeve me karakter profesional dhe/ose programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të shpallura nga IAL-të publike dhe jopublike

c) përcjelljen IAL-ve të bazës së plotë të të dhënave të maturantëve/kandidatëve, që kanë përzgjedhur programet e studimit që këto IAL ofrojnë.

d) procesin e shpalljes së listave renditëse të kandidatëve në rang kombëtar sipas renditjes dhe përlllogaritjes së pikëve nga IAL-të.

e) procesin e regjistrimit dhe të çregjistrimit të studentëve nga IAL publike dhe jopublike për ciklin e parë të studimeve dhe/ose programeve të studimeve me karakter profesional dhe/ose programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, të shpallura nga IAL-të publike dhe jopublike

f) sinkronizimin e regjistrimeve sipas çdo IAL-je në rang kombëtar dhe lëvizjen e vijës së kuqe.

g) dhënien e informacioneve të nevojshme për maturantët/kandidatët për ndjekjen në mënyrë dinamike, përgjatë raundit të parë dhe raundit të dytë, të procesit të shpalljes së fituesve.

4. Aplikimi i maturantëve/kandidatëve me formularët A1 dhe A1Z bëhet në portalin e maturës shtetërore www.matura.qsha.gov.al

5. Hedhja e rezultateve lëndore të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, për maturantët/kandidatët që kanë plotësuar



formularin A1 ose A1Z, bëhet nga drejtoritë e institucioneve arsimore në Portalin Maturantë www.rezultateam.al

6. Për maturantët, të cilët kanë aplikuar me formularin A1, nga drejtoritë e institucioneve arsimore hidhen në portalin www.rezultateam.al të maturantit, të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë.

Rezultatet e të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, me përjashtim të rezultateve të vitit të fundit, hidhen sipas afatit të përcaktuar me Rregulloren e Maturës Shtetërore. Rezultatet e vitit të fundit hidhen pas përfundimit të vitit shkollor, sipas afatit të përcaktuar me Rregulloren e Maturës Shtetërore.

7. Për kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë në vitet e mëparshme dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen në portalin www.rezultateam.al të maturantit, të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, sipas afatit të përcaktuar me Rregulloren e Maturës Shtetërore.

8. Për kandidatët, që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit dhe që kanë aplikuar me formularin A1Z, nga drejtoritë e institucioneve arsimore, ku ata kanë kryer aplikimin, hidhen në portalin www.rezultateam.al të maturantit, të dhënat e lidhura me rezultatet e njehsuara të shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, sipas afatit të përcaktuar me Rregulloren e Maturës Shtetërore.

9. Përzgjedhja e programeve të ciklit të parë të studimeve, të programeve të studimeve me karakter profesional, si dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë, të ofruara nga IAL-të për vitin akademik përkatës, të bëhet në portalin e aplikimit universitar U-Albania <https://ualbania.al/>

10. Regjistrimi i studentëve fitues, të shpallur nga IAL-të të kryhet nga sekretaritë mësimore dhe të pasqyrohet në portalin e aplikimit universitar U-Albania <https://ualbania.al/>

KREU II PROCEDURAT E APLIKIMIT

Afati i aplikimit, rëndësia e tij

1. Maturantët/kandidatët, për ndjekjen e studimeve në IAL-të publike dhe jopublike, në programet e ciklit të parë të studimeve, në

programet e studimeve me karakter profesional dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, me kohë të plotë, duhet të kryejnë procesin e aplikimit në portalin e aplikimit universitar U-Albania.

2. Aplikimi kryhet nga maturantët/kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë dhe plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) janë pajisur me dokumentacionin ligjor të përfundimit të arsimit të mesëm të lartë

b) plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave

c) plotësojnë kriteret shtesë të përcaktuara nga IAL-të për programet e studimit për të cilat aplikojnë

d) nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. Maturantët/kandidatët, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 (dy mijë) lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Periudha e kryerjes së pagesës dhe afati i dorëzimit të mandatit të pagesës si dhe konfirmimi në portalin U-Albania nga sekretaritë e shkollave, përcaktohen në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik.

4. Sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, maturantët/kandidatët që duan të ndjekin studimet në IAL, përfshirë edhe kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë jashtë vendit, pas pagesës së tarifës së aplikimit, do të aplikojnë në portalin U-Albania nëpërmjet formularit www.rezultateam.al të aplikimit, mbi bazën e notës mesatare sipas VKM-së përkatëse mbi kriterin e notës mesatare dhe kriterëve të tjera të përcaktuara nga IAL-të.

5. Maturantët/kandidatët, që aplikojnë për t'u pranuar në programet e studimeve dyvjeçare me karakter profesional nuk kanë detyrimin të plotësojnë kriterin e notës mesatare të parashikuar në VKM përkatëse mbi kriterin e notës mesatare.

6. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti sipas procedurave të përshkruara



në udhëzuesin teknik, të publikuar në faqen zyrtare të portalit U-Albania.

7. Kandidatët zgjedhin deri në 10 dhjetë programe studimi nga lista e programeve të studimit, që ofrohen nga IAL-të publike/jopublike, për vitin akademik përkatës.

8. Drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (këtu e në vijim DRAP/ZVAP duhet të marrin masa për krijimin e kushteve mjedise, asistencë teknike, këshilluese etj.) për t'iu ofruar maturantëve/kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar, lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

9. Portali U-Albania nuk do të pranojë aplikime nga maturantët/kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kriterin e notës mesatare, të përcaktuar me VKM-në përkatëse, për programet e ciklit të parë të studimeve dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë me kohë të plotë.

B Përjetja e të dhënave dhe rezultateve, rrethi i nderimit të cilëve dhe i listës së maturantëve/kandidatëve të renditur, rëndi i arë

1. Sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, QSHA-ja i përcjell RASH, në formë elektronike dhe zyrtarisht, listën e maturantëve/kandidatëve që kanë aplikuar me formularët A1/A1Z, të dhënat sa më poshtë:

a ID e maturës

b Të dhënat personale dhe të dhëna shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP) llojin e formularit

c Indekset e profileve të shkollave të mesme të larta.

2. Sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, QSHA-ja i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo maturant/kandidat të dhënat sa më poshtë:

a ID e maturës

b të dhënat personale dhe të dhënat shkollore (shkolla, DRAP/ZVAP) llojin e formularit

c notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme

d rezultatet e provimeve të maturës shtetërore

e mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë

f mesataren e provimeve të maturës shtetërore

g mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM-së për kriterin e notës mesatare

h indokset e profileve të shkollave të mesme të larta.

3. IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi shkarkojnë nga Portali U-Albania listën e aplikantëve që konkurrojnë në programet përkatëse të studimit, sipas kalendarit të miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik.

4. Në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, IAL-të që zhvillojnë konkurse/testime pranimi, afishojnë në mjediset e tyre dhe në faqet zyrtare elektronike përkatëse, listat e aplikantëve. Në periudhën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, do të zhvillohen konkurset e pranimit.

5. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, RASH-i i përcjell, në formë elektronike dhe zyrtarisht, QSHA-së listën e aplikantëve të raundit të parë për çdo program studimi, për fushat e mëposhtme:

a IAL

b njësia kryesore e IAL-së

c cikli i studimit

d programi i studimit

e ID e maturës

f të dhënat personale të aplikantit.

6. Në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, IAL-të mund të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

a listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi

b notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë

c rezultatet e provimeve të maturës shtetërore

d mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë

e mesataren e provimeve të maturës shtetërore

f mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM-së për kriterin e notës mesatare

g indokset e profileve të shkollave të mesme të lartë.

7. Të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, pas kryerjes së



përlogaritjes së pikëve për çdo konkurrent, sipas kritereve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati, si dhe renditjes së tyre në varësi të pikëve të grumbulluara, afishojnë në mjediset publike, si dhe në faqen e saj zyrtare listat e renditjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

8. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, të gjitha IAL-të, duke përfshirë edhe ato që zhvillojnë konkurse/testime, afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre të maturës, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrut ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

që Pr që ed që rat e a që i që imit, ra që ndi i d që të

1. Në periudhën e caktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, do të kryhet procesi i aplikimit që që që që për raundin e dytë në Portalin U-Albania. Kanë të drejtë të aplikojnë, duke përzgjedhur deri në 10 që dhjetë që programe studimi, të gjithë maturantët/kandidatët, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e maturës shtetërore, por që:

a që nuk kanë arritur të aplikojnë në raundin e parë që

b që kanë kryer procesin e aplikimit që që që që në raundin e parë dhe nuk janë shpallur fitues që

c që kanë kryer procesin e aplikimit që që që që në raundin e parë dhe nuk kanë arritur të regjistrohen që

d që janë çregjistruar pas përfundimit të raundit të parë.

2. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti që sipas procedurave të përshkruara në Udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të RASH-it që

3. Nga drejtoritë e institucioneve arsimore, për të gjithë maturantët/kandidatët që kanë aplikuar me formularin A1 dhe A1Z, hidhen në portalin që që që që të maturantit të dhënat e lidhura me rezultatet e shkollimit të të gjitha viteve të arsimit të mesëm të lartë, deri në datën e përcaktuar në kalendarin e

miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik.

4. DRAP/ZVAP-të të marrin masa për krijimin e kushteve që mjedisë, asistencë teknike, këshilluese, etj.) për të ofruar maturantëve/kandidatëve që ndihmë të kërkuar lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

5. Maturantët/kandidatët, që nuk kanë aplikuar në raundin e parë, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 që dymijë që lekë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim, të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Maturantët/kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë dhe do të riaplikojnë në raundin e dytë, nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për këtë raund. Periudha e kryerjes së pagesës, afati i dorëzimit të mandatit të pagesës, si dhe konfirmimi në portalin U-Albania nga sekretaritetë e shkollave, përcaktohen në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik.

6. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, RASH-i i përcjell, në formë elektronike dhe zyrtarisht, QSHA-së listën e aplikantëve të raundit të dytë për çdo program studimi, sipas fushave të mëposhtme:

a që IAL që

b që njësia kryesore e IAL-së që

c që cikli i studimit që

d që programi i studimit që

e që ID e maturës që

f që të dhënat personale të aplikantit.

që Për që je që ja e të d që ëna që e d que re që tate que, r que e i i që ër que aritje que që i que ë que d que e que e i que i que ta que të mat que rantë que e que kandidatë que e të rendit que r, ra que ndi i d que të

1. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, QSHA-ja i përcjell RASH-it, në formë elektronike dhe zyrtarisht, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

a që ID e maturës que

b që të dhënat personale dhe të dhënat shkollore que shkolla, DRAP/ZVAP, lloji i formularit que

c que notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme que



d) rezultatet e provimeve të maturës shtetërore

e) mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë

f) mesataren e provimeve të maturës shtetërore

g) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM-së për kriterin e notës mesatare

h) indeksat e profileve të shkollave të mesme të larta.

2. Në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH, për çdo vit akademik, IAL-të mund të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

a) listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi

b) numrin personal të maturanit/kandidatit

c) notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë

d) rezultatet e provimeve të maturës shtetërore

e) mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë

f) mesataren e provimeve të maturës shtetërore

g) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM-së për kriterin e notës mesatare

h) indeksat e profileve të shkollave të mesme të lartë.

3. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, kryejnë procesin e përllogaritjeve të pikëve për çdo aplikant, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e aplikantëve të renditur dhe formulën/mënyrën e përllogaritjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

4. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, IAL-të afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrit ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, IAL-të ngarkojnë një kopje

elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

E. Procedurat e aplikimit, raundi i tretë

1. Në periudhën e caktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, do të kryhet procesi i aplikimit për raundin e tretë në Portalin U-Albania. Kanë të drejtë të aplikojnë, duke përzgjedhur deri në 10 dhjetë programe studimi, të gjithë maturanët/kandidatët, të cilët kanë plotësuar formularin A1/A1Z dhe rezultojnë kalues në provimet e maturës shtetërore, por që:

a) nuk kanë arritur të regjistrohen në raundin e parë ose të dytë

b) kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë ose të dytë dhe nuk janë shpallur fitues

c) kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë ose të dytë dhe nuk kanë arritur të regjistrohen

d) janë çregjistruar pas përfundimit të raundit të parë ose të dytë.

2. Aplikimi kryhet në cilindo mjedis që ka akses interneti sipas procedurave të përshkuara në udhëzuesin teknik të publikuar në faqen zyrtare të RASH-it

3. DRAP/ZVAP-të të marrin masa për krijimin e kushteve mjedisë, asistencë teknike, këshilluese, etj.) për t'i ofruar maturanëve/kandidatëve çdo ndihmë të kërkuar lidhur me procesin e aplikimit për pranim në IAL.

4. Maturanët/kandidatët, që nuk kanë aplikuar në raundin e parë ose të dytë, përpara aplikimit për zgjedhjen e preferencave në portalin e aplikimit universitar, kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit në vlerën 2000 lëkë, në zyrat e Postës Shqiptare apo në bankat e nivelit të dytë, nëpërmjet faturës për arkëtim, të cilën e shkarkojnë në portalin U-Albania. Maturanët/kandidatët që kanë aplikuar në raundin e parë ose të dytë dhe do të riaplikojnë në raundin e tretë, nuk duhet të kryejnë pagesën e tarifës së aplikimit për këtë raund. Periudha e kryerjes së pagesës, afati i dorëzimit të mandatit të pagesës, si dhe konfirmimi në portalin U-Albania nga sekretaritet e shkollave, përcaktohen në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik.



5. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, RASH-i i përcjell, në formë elektronike dhe zyrtarisht, QSHA-së listën e aplikantëve të raundit të dytë për çdo program studimi, sipas fushave të mëposhtme:

- a) IAL
- b) njësia kryesore e IAL-së
- c) cikli i studimit
- d) programi i studimit
- e) ID e maturës
- f) të dhënat personale të aplikantit.

Fletorja e të dhënave dhe rezultateve, rregullorja e regjistrimit të aplikantëve dhe i listave të maturantëve dhe kandidatëve të renditur, raundi i tretë

1. Në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, IAL-të shkarkojnë nga portali U-Albania, për çdo program studimi të ofruar nga ana e tyre:

- a) listën e aplikantëve që kanë përzgjedhur ato programe studimi
- b) numrin personal të maturantit/kandidatit
- c) notat e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë
- d) rezultatet e provimeve të maturës shtetërore
- e) mesataren e të gjitha viteve të shkollës së mesme të lartë
- f) mesataren e provimeve të maturës shtetërore
- g) mesataren e përgjithshme të përllogaritur sipas VKM-së për kriterin e notës mesatare
- h) indeksat e profileve të shkollave të mesme të lartë.

2. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë kryejnë procesin e përllogaritjeve të pikëve për çdo aplikant, sipas kriterëve të pranimit të përcaktuara nga IAL-ja me vendim senati. IAL-të për çdo program studimi që ofrojnë, publikojnë listat e aplikantëve të renditur dhe formulën/mënyrën e përllogaritjes. Pas fituesit të fundit vendoset vija e kuqe, në varësi të kuotave të ofruara për programin përkatës të studimit.

3. Brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, IAL-të afishojnë dhe publikojnë listat e renditjes së aplikantëve, duke përdorur si element identifikimi vetëm ID e tyre, në mënyrë që të respektohen përcaktimet e kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale. Brenda

datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, IAL-të ngarkojnë një kopje elektronike të këtyre listave në portalin U-Albania.

KREU III

PROCEDURAT E REGJISTRIMIT, ÇREGJISTRIMIT DHE ANKIMIMIT

Aparatet e regjistrimit, raundi i parë

1. Në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e parë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit me dokumentacion në sekretariatë mësimore të IAL-ve në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

2. Periudha e parashikuar në kreun III, A/1 është e ndarë në 7 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në njërin apo disa programe studimi, nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kur ai është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48-orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit, në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

4. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të, për të cilat:

a) nuk përcaktohen kriteret shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare

b) numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara

nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit, gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të parë.

5. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 7 fazave 48-orëshe MASR-ja dhe RASH-i do të publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare: www.arsimi.gov.al dhe <https://ualbania.al/>

6. Procesi i regjistrimeve nga sekretariatë mësimore, me dokumentacion dhe [] vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës



të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e fituesve të raundit të parë.

7. Në rast se pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Këto faza vijojnë deri në plotësimin e kuotave dhe përfundojnë në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara, të cilat nuk kanë aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes së aplikantëve për raundin e parë.

8. Brenda datës të përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, RASH-i përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të parë bashkë me kuotat e paplotësuara në format elektronik dhe në *hard*:

a) IAL

b) njësia kryesore e IAL-së

c) cikli i studimit

d) programi i studimit

e) data e regjistrimit

f) ID e maturës

g) të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.

9. Aplikantët fitues në një program studimi, të cilët nuk janë regjistruar sipas afateve të raundit të parë, humbasin të drejtën për t'u regjistruar. Ata kanë të drejtën që të plotësojnë formularin e aplikimit të raundit e dytë.

Procedura e regjistrimit, raundi i parë

1. Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mësimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda këtij afati, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania nga sekretaria mësimore e fakultetit.

2. Sekretaritetë mësimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, përcjellin në portalin U-Albania listën e aplikantëve të çregjistruar në format elektronik, brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik.

Procedura e ankimimit, raundi i parë

1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL-të përkatëse në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, pasqyrojnë në format elektronik në portalin U-Albania, brenda datës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve.

3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, vijojnë procedurat e regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata duhet të çregjistrohen nga programi i studimit nëse janë regjistruar dhe të regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik. Nëse nuk ka çregjistrime (nuk ka kuota të lira) dhe ankimimi/et pranohen, atëherë IAL dërgon në MASR kërkesën për rialokim kuotash.

Procedura e regjistrimit, raundi i dytë

1. Në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e dytë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit pranë IAL-ve, me dokumentacion në sekretaritetë mësimore në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

2. Periudha e parashikuar në kreun III, D/1 është e ndarë në 5 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij



në njërin apo disa programe studimi nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kur aplikanti është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48 orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

4. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të, për të cilat:

a) nuk përcaktohen kritere shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare

b) numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara

nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit, gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të dytë.

5. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 5 fazave 48-orëshe MASR-ja dhe RASH-i do të publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare www.arsimi.gov.al dhe në portalin U-Albania <https://ualbania.al/>

6. Procesi i regjistrimeve nga sekretaritë mesimore, me dokumentacion dhe vijon me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e renditura të raundit të dytë. Në rast se, pas çdo faze konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk kanë aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes së aplikantëve për raundin e dytë.

7. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, RASH-i përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të raundit të dytë në format elektronik dhe *hard*

a) IAL

b) njësia kryesore e IAL-së

c) cikli i studimit

d) programi i studimit

e) data e regjistrimit

f) ID e maturës

g) të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.

8. Aplikantët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit, për atë vit akademik.

Eproni i regjistrimit, raundi i d

1. Aplikanti, pasi ka bërë regjistrimin me dokumentacion dhe ka nënshkruar në regjistër, ka të drejtë të çregjistrohet vetëm në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik. Ai paraqet një kërkesë për çregjistrim pranë sekretarisë mesimore të fakultetit ku është regjistruar, duke tërhequr dokumentet e dorëzuara. Nëse nuk e kryen këtë veprim brenda kësaj date, ai nuk ka të drejtë ta ndryshojë programin e studimit për këtë vit akademik. Çregjistrimi kryhet në portalin U-Albania nga sekretaria mesimore e fakultetit.

2. Sekretaritë mesimore, në përfundim të procesit të çregjistrimit të aplikantëve dhe dorëzimit të dokumentacionit, dërgojnë në RASH listën e aplikantëve të çregjistruar, sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik.

Eproni i ankimimit, raundi i d

1. Aplikantët kanë të drejtën e ankimimit në IAL në datën e përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik. Brenda 24 orëve nga momenti i paraqitjes së ankesave, IAL-të duhet të shprehen me vendim lidhur me ankimimet. Vendimet e IAL-ve ankimohen në gjykatën kompetente.

2. IAL-të, pas përfundimit të afatit të ankimimit dhe shqyrtimit të ankesave, përcjellin zyrtarisht në RASH, brenda datës së përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, vendimet lidhur me ankimimet e aplikantëve si dhe pasqyrojnë brenda po kësaj date në portalin U-Albania këto vendime në format elektronik.

3. Aplikantët, pavarësisht paraqitjes së ankesës, nëse janë shpallur fitues në një ose disa programe të tjera studimi, vijojnë procedurat e



regjistrimit. Nëse ankesa e tyre është pranuar, ata duhet të çregjistrohen nga programi i studimit nëse janë regjistruar dhe të regjistrohen në programin e studimit, në të cilin është pranuar ankimimi, në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik. Nëse nuk ka çregjistrime nuk ka kuota të lira dhe ankimimi/et pranohen, atëherë IAL dërgon në MASR kërkesën për rialokim kuotash.

Prëftimi i regjistrimit, raundi i tretë

1. Në datat e përcaktuara në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, të gjithë aplikantët, të cilët kanë kryer procesin e aplikimit në raundin e tretë dhe janë shpallur fitues, kryejnë procesin e regjistrimit pranë IAL-ve, me dokumentacion në sekretariatë mësimore në programin e studimit ku dëshirojnë të vazhdojnë studimet.

2. Periudha e parashikuar në kreun III, G/1 është e ndarë në 3 faza 48-orëshe. Secili aplikant ndjek ecurinë e procesit të shpalljes fitues të tij në një apo disa programe studimi, nga ato që ka përzgjedhur në formularin e aplikimit.

3. Kur aplikanti është shpallur fitues, duhet të paraqitet pranë IAL-së ku dëshiron të regjistrohet, brenda afatit 48-orësh. Nëse aplikanti nuk regjistrohet brenda afatit 48 orësh, ai humbet të drejtën e regjistrimit në ato programe studimi ku ishte shpallur fitues në atë fazë.

4. Për programet e studimit të ofruara nga IAL-të, për të cilat:

a) nuk përcaktohen kritere shtesë nga IAL-ja përkatëse, me përjashtim të notës mesatare

b) numri i kandidatëve është i njëjtë apo më i ulët se numri i kuotave të miratuara

nuk aplikohet ndarja në faza 48-orëshe dhe kandidatët kanë të drejtën e regjistrimit, gjatë gjithë periudhës së regjistrimeve të raundit të tretë.

5. Për ndjekjen e ecurisë së procesit të shpalljes së fituesve gjatë 3 fazave 48-orëshe MASR-ja dhe RASH-i do të publikojnë një udhëzues teknik në faqet përkatëse zyrtare www.arsimi.gov.al dhe në portalin U-Albania <https://ualbania.al/>

6. Procesi i regjistrimeve nga sekretariatë mësimore, me dokumentacion dhe vijon

me faza 48-orëshe, në përputhje me numrin e kuotave të parashikuara për programin përkatës të studimit dhe duke respektuar renditjen në listat e renditura të raundit të tretë. Në rast se, pas çdo faze 48-orëshe, konstatohen kuota të paplotësuara, zhvendoset vija e kuqe dhe shpallen fitues të rinj të asaj faze. Këta fitues të rinj regjistrohen vetëm në fazën pasardhëse. Për programet e studimit me kuota të paplotësuara të cilat nuk kanë aplikantë në pritje, do të rikthehen në garë aplikantët e shpallur fitues në fazat paraardhëse, të cilët nuk rezultojnë të regjistruar në programe të tjera studimi. Rikthimi në garë kryhet sipas listës së renditjes së aplikantëve për raundin e tretë.

7. Gjatë periudhës së përcaktuar në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, pas përfundimit të 3 tri fazave 48-orëshe të regjistrimit, IAL-të vijojnë me procedurat e regjistrimit të kandidatëve nëpërmjet portalit U-Albania në programet e studimit në të cilat kanë aplikuar në raundin e tretë. Të drejtën e regjistrimit e kanë kandidatët që nuk rezultojnë të regjistruar në një program tjetër studimi. IAL-të gjatë regjistrimeve respektojnë renditjen e kandidatëve deri në plotësimin e kuotave.

8. Sipas afatit të përcaktuar, në kalendarin e miratuar me urdhër të titullarëve të QSHA-së dhe RASH-it, për çdo vit akademik, RASH-i përcjell në QSHA regjistrimet përfundimtare të të tri raundeve në format elektronik dhe *hard*:

a) IAL

b) njësia kryesore e IAL-së

c) cikli i studimit

d) programi i studimit

e) data e regjistrimit

f) ID e maturës

g) të dhënat personale të kandidatit të regjistruar.

9. Aplikantët, të cilët kanë bërë regjistrimin me dokumentacion dhe kanë nënshkruar në regjistër, nuk kanë të drejtë të ndryshojnë programin e studimit, për atë vit akademik.

KREU IV

DOKUMENTACIONI PËR REGJISTRIM

1. Aplikantët fitues duhet të regjistrohen vetëm në një program studimi, me përjashtim të



nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer. Pas marrjes së dokumentacionit nga aplikanti dhe regjistrimit të tij, sekretaria bën regjistrimin [] në Portalin U-Albania. Aplikantët dorëzojnë personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesit të autorizuar me prokurë nga ana e tyre, dokumentacionin e mëposhtëm:

a) dokumentin e identifikimit [kartë identiteti ose pasaportë]. Në dosje mbahet vetëm fotokopja.

b) fotokopjen e noterizuar të diplomës së maturës shtetërore ose të dëftesës së pjekurisë, së bashku me certifikatën e notave ose të një dëftese/diplome tjetër studimi të fituar jashtë vendit dhe të njehsuar në QSHA.

c) deklaratën e paraqitur në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi, e cila plotësohet nga aplikanti në prani të punonjësës së sekretarisë mësimore të IAL-së dhe që nënshkruhet nga aplikanti dhe nga punonjësja e sekretarisë.

2. Sekretarët mësimore mbajnë regjistër të veçantë për dorëzimin e dokumentacionit, datën dhe orën e dorëzimit, si dhe nënshkrimin e aplikantëve të regjistruar. Pas nënshkrimit në regjistër, nga ana e sekretarisë mësimore, në prani të aplikantit kryhet regjistrimi [] në Portalin U-Albania. Në fund të procedurës, nga aplikanti dhe sekretarja firmoset në dy kopje formulari i printuar nga sistemi, një prej të cilave i jepet aplikantit.

KREU V DISPOZITA TË FUNDIT DHE HYRJA NË FUQI

1. IAL-të dorëzojnë në QSHA, në formë zyrtare dhe elektronike, brenda datës 30 nëntor të çdo viti akademik, listat përfundimtare të studentëve të regjistruar për pajisjen e studentëve me numër matrikullimi, sipas udhëzimit nr. 6, datë 19.2.2018, “Për gjenerimin dhe dhënien e numrave të matrikullimit”.

2. Kandidatët e shpallur fitues në programet e të gjitha cikleve të studimit nuk mund të regjistrohen për të ndjekur njëkohësisht dy programe studimi në IAL-të publike dhe/ose jopublike, në të njëjtën vit akademik, me përjashtim të nxënësve dhe studentëve të shkëlqyer.

3. IAL-të të përpilojnë një raport të hollësishëm në lidhje me regjistrimet e studentëve në afatet dhe

formatet e kërkuara sipas udhëzimit të ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 5, datë 19.2.2018, “Për përcaktimin e elementeve përbërëse të raportimit vjetor dhe afatit për raportim të institucioneve të arsimit të lartë”. Ky raport të dërgohet në MASR brenda datës 31 dhjetor të çdo viti akademik.

4. Ngarkohen Qendra e Shërbimeve Arsimore dhe Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar për miratimin e kalendarit, për procedurat e aplikimit dhe të regjistrimit, për çdo vit akademik, si dhe publikimit të tij brenda muajit janar të çdo viti kalendarik.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar, drejtoritë rajonale dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe IAL-të publike dhe jopublike.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Bela Sani

SHTOJCA NR.1

DECLARATË

Unë i nënshkruari [], lindur më [] emri atësia mbiemri me kartë identiteti/pasaportë nr. []

1. Autorizoj institucionin e arsimit të lartë Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për trajtimin e të dhënave të mia personale në kuadër të aplikimit dhe regjistrimit për vazhdimin e studimeve universitare në Institucionin e sipërcituar, si dhe publikimin eventual të tyre. Autorizoj, gjithashtu Institucionin e Arsimit të Lartë ku kam aplikuar, Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Qendrën e Shërbimeve Arsimore për kryerjen e të gjitha verifikimeve dhe marrjen e të gjitha informacioneve lidhur me: studimet universitare ku kam aplikuar për t'u



fillimit të vitit mësimor dhe gjatë vitit menjëherë nga njoftimi për vendin e lirë të punës.

7. Vendet e lira të punës shpallen pasi është bërë plotësimi i kërkesave për lëvizje paralele dhe sistemimi i mësuesve që mbeten pa ngarkesë mësimore në zyrat vendore të arsimit parauniversitar në vazhdim ZVAP deri në 1 maj ditë para fillimit të vitit mësimor.

8. DRAP ka detyrimin të raportojë në DPAP lëvizjet paralele dhe vendet e lira të punës 1 maj ditë përpara fillimit të vitit mësimor.

9. DRAP ka detyrimin të konfirmojë menjëherë në portalin “Mësues për Shqipërinë”, përgjatë vitit mësimor, vendet e lira të punës për çdo institucion arsimor parauniversitar të varësisë, si dhe listën e punësimeve të kryera në muajin paraardhës, brenda 5 ditëve të para të çdo muaji.

10. DRAP dhe institucionet e varësisë kanë detyrimin të bëjnë publike vendet e lira të punës, në portalin “Mësues për Shqipërinë”, në faqen zyrtare të tyre dhe në stendat e informimit publik.

11. DRAP dhe institucionet e varësisë kanë detyrimin të bëjnë publike menjëherë punësimet për çdo institucion arsimor në portalin “Mësues për Shqipërinë”, në faqen zyrtare të tyre dhe në stendat e informimit publik.

12. Kandidatët e interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit duhet të regjistrohen në portalin “Mësues për Shqipërinë” sipas procedurave dhe afateve të përcaktuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në vazhdim “MASR”).

KREU 2 KONKURRIMI

1. Konkurrimi zhvillohet në dy faza:

- a) vlerësim me dosje
- b) testim i informatizuar.

2. Në fazën e parë, kandidati i interesuar për të ushtruar profesionin e mësuesit dërgon në DRAP, ku kandidati ka qendrën e banimit, dosjen e aplikimit për konkurrim.

3. Dosja e aplikimit dërgohet me postë sipas afateve të përcaktuara nga DRAP.

4. Lista e dokumenteve që duhet të përmbajë dosja e aplikimit, është sipas shtojcës 1,

bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse e tij.

5. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban dokumentet e detyrueshme sipas shtojcës 1, përjashtohet nga të gjitha fazat e konkurimit.

6. Kandidatët kanë të drejtë të konkurrojnë deri në tri ZVAP.

7. Kandidati, i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin e fundit dhe dëshiron të konkurrojë, duhet të dërgojë me postë në DRAP, ku kandidati ka qendrën e banimit, kërkesën për konkurrim sipas shtojcës 4, në të kundërt përjashtohet nga portali.

8. Kandidatit, i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin 2018 dhe dëshiron të ruajë pikët e dosjes, do t'i konvertohen pikët sipas shtojcës 2 të këtij udhëzimi nga DRAP, pas transferimit të dosjes nga ZVAP, sipas kërkesës së DRAP. Kandidati paraqet kërkesën për konkurrim sipas shtojcës 4 në DRAP, në të kundërt përjashtohet nga portali.

9. Kandidatit, i cili ka qenë pjesëmarrës në portalin 2018 dhe dëshiron të ruajë pikët e testimit të informatizuar, dërgon kërkesën në DPAP sipas shtojcës 4, në të kundërt përjashtohet nga portali. DPAP merr nga QSHA rezultatet zyrtare të kandidatit dhe i pasqyron në “Portalin Mësues për Shqipërinë”.

10. Në fazën e dytë, “Testim i informatizuar”, marrin pjesë kandidatët që janë regjistruar në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe kanë kaluar me sukses fazën e parë “Vlerësim me dosje”.

11. Aplikimi për pjesëmarrje në testim, mënyra e testimit dhe vlerësimi përcaktohen në udhëzimin përkatës të MASR-së.

12. Për të marrë pjesë në testimin e informatizuar, kandidati duhet të pajiset me formularin e lëshuar nga Komisioni i Vlerësimit të Dosjeve të DRAP-së, sipas shtojcës 3 të këtij udhëzimi, pranë ZVAP sipas vendbanimit.

13. Rezultatet e vlerësimit të dosjes dhe të testimit të informatizuar për çdo kandidat bëhen transparente nëpërmjet faqes elektronike zyrtare të çdo DRAP/ZVAP-je dhe në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

14. Administrimi i listës së kandidatëve bëhet nga DRAP dhe ZVAP sipas renditjes dhe profileve të shpallura në portalin DPAP.



KREU 3 ADMINISTRIMI I PORTALIT “MËSUES PËR SHQIPËRINË”

1. Informacioni mbi aplikimet [1] të kandidatëve, shpallja e vendeve të lira të punës, konkurrimi, renditja e kandidatëve për mësues dhe pranimi në një vend të lirë pune realizohen nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe në faqen elektronike zyrtare të DPAP-së.

2. DPAP është përgjegjës për publikimin elektronik të informacionit në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

3. Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (në vazhdim “RASH”), është përgjegjës për administrimin e softit elektronik të portalit “Mësues për Shqipërinë” dhe të regjistrimit [1] të kandidatëve për të marrë pjesë në konkurrim.

4. Hedhja e të dhënave mbi rezultatet e kandidatëve nga vlerësimi i dosjeve bëhet në DPAP në llogarinë nëpërmjet funksionalitetit në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

5. RASH-i, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, zbaton funksionalitetin, i cili ngarkon rezultatet e testimit të informatizuar të cilat i përcillen zyrtarisht nga Qendra e Shërbimeve Arsimore.

6. RASH-i, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, zbaton funksionalitetin, i cili bën renditjen e kandidatëve sipas pikëve totale [shuma e pikëve të dosjes dhe pikëve të testimit] për kandidatët për çdo ZVAP dhe për çdo profil.

7. RASH-i, nëpërmjet portalit “Mësues për Shqipërinë”, i vë në dispozicion ZVAP-së funksionalitetin për pranimin ose refuzimin e një vendi pune nga ana e kandidatit.

8. RASH-i garanton që portali “Mësues për Shqipërinë” prodhon aktin e pranimi të vendit të punës.

KREU 4 PROCEDURAT E PUNËSIMIT TË MËSUESVE

1. Rënditja e kandidatëve, të cilët kanë përfunduar të dy fazat e konkurrimit, fillon me kandidatin që ka më shumë pikë dhe vijon me rend zbritës për çdo profil dhe çdo ZVAP.

2. Rënditja e kandidatëve administrohet nga DPAP dhe shpallet në portalin “Mësues për Shqipërinë” dhe në faqen elektronike zyrtare të saj.

3. Çdo DRAP dhe ZVAP ka detyrimin të shpallë në faqen elektronike zyrtare dhe në stendat e informimit publik listat e kandidatëve të renditur sipas profileve, për institucionet arsimore të varësisë.

4. Për një vend të lirë pune, kandidati njoftohet nga ZVAP përmes postës elektronike, të cilën kandidati e ka deklaruar gjatë aplikimit [1] dhe me dosje.

5. Kandidati, i cili në renditjen e përgjithshme është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës dhe është i detyruar të konfirmojë në ZVAP brenda 24 orëve nëpërmjet adresës elektronike. Në rast të moskonfirmimit nga kandidati, ky pozicion pune i ofrohet kandidatit të listuar një rend më poshtë. Midis kandidatëve që rezultojnë me pikë të barabarta, përparësi ka kandidati që mund të jetë në kategorinë e personave me aftësi të kufizuara. Në rast se nuk ka persona me aftësi të kufizuara, vendi i lirë i punës i ofrohet kandidatit që ka rezultatin më të lartë në testim.

6. Çdo kandidat ka të drejtën e refuzimit deri në pozicionin që ai preferon. Refuzimi i vendit të punës nga ana e kandidatit pasqyrohet në portal nga ana e DPAP dhe ZVAP, e cila informon DRAP-në.

7. Kandidati fitues paraqitet në institucionin arsimor ku ofrohet vendi i lirë i punës menjëherë sapo merr njoftimin. Ai i dorëzon drejtorit të institucionit dokumentin vërtetues, të printuar nga sistemi i aplikimit [1], në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

8. Mësuesit ndihmës do të punësohen nga kandidatët e portalit “Mësues për Shqipërinë” të profilit “Arsim special”, sipas procedurave të këtij udhëzimi.

9. Kandidati punësohet nga drejtori i institucionit arsimor me kontratë pune individuale, me ose pa afat, sipas kërkesave të vendit të lirë të punës.

10. Kontrata nënshkruhet ndërmjet kandidatit dhe drejtorit të institucionit arsimor.

11. DRAP, në fund të çdo muaji, njofton zyrtarisht DPAP-në për punësimet e përhershme



apo të përkohshme të bëra nga drejtorët e institucioneve arsimore në juridiksion të saj.

12. Për të gjithë kandidatët që kanë përzgjedhur një vend pune të përhershëm dhe janë emëruar me kontratë pune pa afat, ndryshon statusi i tyre në portal, në statusin “I punësuar”.

13. Për të gjithë kandidatët që kanë përzgjedhur një vend pune të përhershëm dhe janë emëruar me kontratë pune me afat, ndryshon statusi i tyre në portal, në statusin “I punësuar përkohësisht”.

14. Në rast refuzimi të kandidatit fitues për vendin e lirë të propozuar, kandidati vazhdon të qëndrojë në renditje dhe atij i ofrohen vende pune të tjera të lira, deri në procedurat e hapjes së portalit të ri “Mësues për Shqipërinë”.

KREU 5

PROCEDURAT E PUNËSIMIT PËR RASTE TË VEÇANTA

1. Kur në një ZVAP nuk ka kandidatë të renditur në portal, sipas profilit që përkon me vendin e lirë të punës, njoftohen dhe emërohen ata kandidatë që janë të renditur në portal në një profil të përafërt me profilin e kërkuar, duke respektuar procedurat e këtij udhëzimi.

2. Profili i përafërt përcaktohet sipas udhëzimit të ministrit të MASR-së nr. 30, datë 12.09.2018 “Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit parauniversitar”.

3. Kur nuk ka kandidatë me profil të përafërt, DRAP njofton mësuesit e të njëjtit profil me profilin e kërkuar në të gjitha ZVAP-të nën varësi dhe punësohet kandidati i renditur me numrin më të madh të pikëve, duke respektuar procedurat e këtij udhëzimi.

4. Në mungesë të kandidatëve të profilit “Arsim special”, për plotësimin e vendeve të lira për mësues ndihmës, ZVAP vepron si më poshtë:

a) nëse nga institucionet arsimore do të kërkohen mësues ndihmës në arsimin fillor, ZVAP do të njoftojë për punësim kandidatët nga portali “Mësues për Shqipërinë” në profilin “Arsim fillor” sipas renditjes.

b) nëse nga institucionet arsimore, do të kërkohen mësues ndihmës në arsimin e mesëm të ulët ose në arsimin e mesëm të lartë, ZVAP do

të njoftojë për punësim kandidatët nga portali “Mësues për Shqipërinë” të të gjitha profileve sipas renditjes.

5. Në rast se në përfundim të procedurave të këtij kreu rezultojnë përsëri vend pune i lirë, ZVAP do të zhvillojë procedurat e konkurrimit me kandidatët e tjerë të interesuar, duke i renditur me pikë sipas nivelit të arsimimit dhe profilit të përafërt me kërkesat e vendit të punës.

6. Kontrata e punës për kategorinë e mësuesve të përcaktuar në këtë krye, lidhet me afat të caktuar, deri në momentin e paraqitjes së një kandidati nga “Portali Mësues për Shqipërinë”.

KREU 6

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË DOSJEVE

1. DRAP krijon Komisionin e Vlerësimit të Dosjeve (në vazhdim “KVD”), me këtë përbërje:

a) drejtori i DRAP kryetar

b) një përfaqësues i sektorit të burimeve njerëzore, shërbimeve dhe statistikës anëtar

c) dy përfaqësues të sektorit të kurrikulës dhe zhvillimit profesional anëtar

d) një mësues nga shkollat nën juridiksion të DRAP-së, i cili ka të paktën kategorinë e kualifikimit “Mësues specialist” dhe vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në ushtrimin e profesionit anëtar

e) një përfaqësues i prindërve anëtar

f) një psikolog ose punonjës social që mbulon shkollat nën juridiksion të DRAP-së anëtar

2. KVD përzgjedh një apo më shumë anëtarë si sekretari teknike për mbajtjen e të dhënave dhe të dokumentacionit të aplikantëve.

3. KVD zbaton rregulloren e brendshme të tij, të miratuar nga drejtori i DRAP-së dhe zbaton këto detyra:

a) administron dokumentacionin e kandidatëve për mësues

b) njofton përfaqësuesit e bashkisë për pjesëmarrje, si dhe përfaqësuesit e sindikatave, si vëzhgues në mbledhjet e komisionit

c) shqyrton plotësimin e kriterëve ligjore të çdo kandidati për të ushtruar profesionin e mësuesit

d) vlerëson me pikë, sipas shtojcës 2, dokumentacionin e paraqitur nga kandidatët



e shqyrton rastet e mbartjes së pikëve apo të përditësimit të dosjeve sipas deklaratave të kandidatëve.

f harton listën për çdo profil/lëndë sipas çdo ZVAP-je me ID-të përkatëse.

g publikon në faqen elektronike zyrtare, pikët e dosjeve për çdo kandidat, me ID-në përkatëse, sipas profileve, për çdo ZVAP që ka në varësi.

h pajis çdo kandidat me formularin e pjesëmarrjes në testimin e informatizuar, sipas shtojcës 3 të këtij udhëzimi, nëpërmjet ZVAP.

i dërgon elektronikisht dhe zyrtarisht në DPAP listën përfundimtare me pikët e dosjes të çdo kandidati sipas profileve dhe kandidatëve të skualifikuar.

4. Skema e vlerësimit të dosjes së kandidatëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit përcaktohet në shtojcën 2, bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

5. Anëtari i KVD-së duhet të verifikojë dhe të shmangë konfliktin e interesit me kandidatët nëpërmjet deklaramit institucional.

KREU 7

PROCEDURAT PËR LËVIZJET PARALELE

1. Procedurat e lëvizjes paralele administrohen nga ZVAP, vetëm në periudhën nga përfundimi i vitit mësimor deri në fillimin e vitit të ri mësimor.

2. Mësuesi që dëshiron të kryejë lëvizje paralele, dërgon me postë në ZVAP kërkesën dhe dokumentacionin e kërkuar sipas shtojcës 2.1, gjatë gjithë vitit mësimor.

3. Lëvizjet paralele mund të kryhen vetëm brenda një ZVAP-je.

4. Për mësuesit që mbeten pa ngarkesë mësimore drejtori i institucionit arsimor dërgon në ZVAP listën emërore dhe vlerësimin e dosjeve të tyre sipas shtojcës 2.1.

5. ZVAP krijon komisionin e vlerësimit të dosjeve për lëvizje paralele, me këtë përbërje:

a drejtuesi i ZVAP kryetar

b një specialist i kurrikulës dhe zhvillimit profesional në ZVAP anëtar

c juristi i ZVAP anëtar

6. Komisioni i vlerësimit të dosjeve në ZVAP bën vlerësimin e dosjeve të kandidatëve për lëvizje paralele sipas shtojcës 2.1., brenda muajit gusht.

7. Komisioni vlerësimit shpall renditjen e konkurrentëve për lëvizje paralele dhe paralele të detyrueshme sipas pikëve në rendin zbritës. Renditja e mësuesve shpallet në faqen elektronike zyrtare të ZVAP-së.

8. Mësuesi, i cili është renditur me numrin më të madh të pikëve, ka të drejtën e zgjedhjes për vendin e lirë të punës. Ai dërgon brenda 24 orëve me e-mail miratimin ose refuzimin e vendit të propozuar. Në rast të moskonfirmimit nga kandidati, ky vend pune i ofrohet kandidatit të listuar një rend më poshtë.

9. Kur në një institucion arsimor bie numri i ngarkesës mësimore për një profil/lëndë, drejtori i shkollës krijon komisionin për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve të të gjithë mësuesve të atij profili/lënde.

10. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë përbëhet nga: drejtori i shkollës kryetar një mësues i shkollës që vlerësohet për profesionalizëm e korrektësi në profesion anëtar dhe kryetari i këshillit të prindërve të shkollës anëtar.

11. Komisioni për shqyrtimin dhe vlerësimin e dosjeve në shkollë ka për detyrë të bëjë vetëm vlerësimin e dosjeve të mësuesve të profilit/lëndës për të cilën bie numri i orëve sipas shtojcës 2.1, të publikojë rezultatet me ID-të përkatëse dhe të dërgojë në ZVAP listën e mësuesve që mbeten pa ngarkesë me pikët e fituara nga vlerësimi i dosjeve.

12. Të gjithë mësuesve që rezultojnë pa ngarkesë mësimore dhe mbeten të pasistemuar, si pasojë e mungesës së vendeve të punës, u ndërpritet marrëdhënia e punës me të drejtën e konkurrimit sipas këtij udhëzimi.

13. Mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele dhe mësuesit që kanë rezultuar pa ngarkesë mësimore, në rastet kur punësohen në një vend pune të lirë, punësohen me kontratë pune me afat të pacaktuar.

KREU 8

ANKIMI

1. Çdo kandidat ka të drejtën e ankimit për vendimet e komisionit në secilën prej procedurave të zhvilluara për vendet e lira të punës për pozicionin e mësuesit, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.



2. Ankimi i kandidatit protokollohet në drejtorinë e institucionit ku bëhet ankimi, menjëherë pas shpalljes së vendimeve të komisionit/ve dhe jo më vonë se 3 ditë pune pas shpalljes së tyre.

3. Ankimi/et shqyrtohen nga institucioni në bashkëpunim me komisionin përkatës brenda 5 ditëve pune.

4. Vendimi i arritur pas përfundimit të shqyrtimit të ankimit, i bëhet i njohur ankuesit me shkrim nga institucioni.

5. Vendimet e institucioneve ankimohen tek organi epror, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

KREU 9

PEZULLIMI DHE LARGIMI NGA PUNA I MËSUESIT

1. Drejtori i shkollës merr masën e pezullimit ndaj mësuesit kur gjykata vendos ndaj mësuesit masë të sigurimit personal deri në vendimin e formës së prerë.

2. Mësuesit të pezulluar i ndërpriten marrëdhëniet financiare për kohën e pezullimit.

3. Rastet e tjera të pezullimit nga detyra të mësuesit përcaktohen në aktet e tjera nënligjore në fuqi.

4. Largimi i mësuesit nga puna bëhet sipas akteve nënligjore në fuqi.

KREU 10

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Procedurat e ndjekura, dokumentet e administruara dhe vendimet e marra për zbatimin e këtij udhëzimi ruhen në ZVAP/DRAP dhe janë objekt monitorimi dhe inspektimi.

2. Për mësuesit në institucionet parashkolllore, njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e emërimit duke respektuar renditjen në portalin “Mësues për Shqipërinë”.

3. Dosjet e aplikimit të kandidatëve për mësues ruhen për 10 vite shkollore nga shpallja përfundimtare e rezultateve të konkurrimit. Dokumentet e tjera të përcaktuara në këtë udhëzim ruhen për 10 vjet.

4. Udhëzimi i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 38, datë 6.10.2015, “Për procedurat e lëvizjes

paralele, emërimit dhe të largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar”, shfuqizohet.

5. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Përgjithshme Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Qendra e Shërbimeve Arsimore, Qendra Ndërinstitucionale e Rrjetit Akademik Shqiptar (RASH), Drejtorja e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINIS
Bela Sali

SHTOJCA 1

1. Jetëshkrimi.

2. Kërkesë për konkurrimin në portalin “Mësues për Shqipërinë”, sipas shtojcës 4 të këtij udhëzimi i detyrueshëm.

3. Raport mjekoligjor i tre muajve të fundit dhe i detyrueshëm.

4. Deklaratë për gjendjen gjyqësore, sipas shtojcës 5 të këtij udhëzimi i detyrueshëm.

5. Vërtetim i qendrës së banimit i detyrueshëm.

6. Kopje e librezës së punës e njësuar me origjinalin nëse ka.

7. Kopje e njësuar me origjinalin e diplomës/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë, cikli i dytë dhe diplomat e integruara të nivelit të dytë ose të barasvlershme me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi i detyrueshëm.

8. Kopje e njësuar me origjinalin e licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejnë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi i detyrueshëm.

9. Kopje e njësuar me origjinalin e dëshmimeve të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues mjeshtrë” (nëse ka).



10. Kopje e njësuar me origjinalin e certifikatave me kredite të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Certifikatat me kredite të trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MASR-ja, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara nga MASR-ja.

11. Kopje e njësuar me origjinalin e dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja.

12. Deklaratë nga kandidati për autorizimin e DRAP-së që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura sipas shtojcës 6 të këtij udhëzimi.

SHTOJCA 2

Kriteret dhe skema e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve për ushtrimin e profesionit të mësuesit.

1	<p>Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare DIND.</p> <p>Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>Nota mesatare 5.00 - 5.50 □ 1 pikë Nota mesatare 5.51 - 6.00 □ 2 pikë Nota mesatare 6.01 - 6.50 □ 3 pikë Nota mesatare 6.51 - 7.00 □ 4 pikë Nota mesatare 7.01 - 7.50 □ 5 pikë Nota mesatare 7.51 - 8.00 □ 6 pikë Nota mesatare 8.01 - 8.50 □ 7 pikë Nota mesatare 8.51 - 9.00 □ 8 pikë Nota mesatare 9.01 - 9.50 □ 9 pikë Nota mesatare 9.51 - 10.00 □ 10 pikë</p>	1-10 pikë
2	<p>Shkallët e kualifikimit dhe licencimi:</p> <p>Në rast se kandidati zotëron provimin e licencës □ 1 pikë Mësues i kualifikuar □ kategori III □ 2 pikë Mësues specialist □ kategori II □ 3 pikë Mësues mjeshër □ kategori I □ 4 pikë</p> <p>Nëse kandidati zotëron edhe provimin e licencimit, edhe kategorinë e kualifikimit, vlerësohet për të dy treguesit.</p>	0-4 pikë
3	<p>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja:</p> <p>a □ Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike □ 2 pikë. b □ Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 □ 2 pikë. c □ Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 □ 4 pikë.</p> <p>Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve universitare të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës.</p> <p>Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 4 pikë në vlerësimin e dosjes.</p> <p>Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për një dëshmi.</p> <p>Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.</p>	0-4 pikë
4	<p>Certifikata trajnimesh:</p> <p>Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>a □ deri në 3 kredite □ 1 pikë, b □ mbi 3 kredite □ 2 pikë.</p>	0-2 pikë



SHTOJCA 2.1

Kriteret dhe skema e vlerësimit të dosjeve të kandidatëve për rastin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, për shkak të mungesës së ngarkesës mësimore.

1	<p>Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore <input type="checkbox"/> nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II/2, ose nota mesatare DIND. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>Nota mesatare 5.00 - 5.50 <input type="checkbox"/> 1 pikë Nota mesatare 5.51 - 6.00 <input type="checkbox"/> 2 pikë Nota mesatare 6.01 - 6.50 <input type="checkbox"/> 3 pikë Nota mesatare 6.51 - 7.00 <input type="checkbox"/> 4 pikë Nota mesatare 7.01 - 7.50 <input type="checkbox"/> 5 pikë Nota mesatare 7.51 - 8.00 <input type="checkbox"/> 6 pikë Nota mesatare 8.01 - 8.50 <input type="checkbox"/> 7 pikë Nota mesatare 8.51 - 9.00 <input type="checkbox"/> 8 pikë Nota mesatare 9.01 - 9.50 <input type="checkbox"/> 9 pikë Nota mesatare 9.51 - 10.00 <input type="checkbox"/> 10 pikë</p>	1-10 pikë
2	<p>Shkallët e kualifikimit dhe licencimi:</p> <p>a) Në rast se kandidati zotëron provimin e licencës 1 pikë b) Mësues i kualifikuar <input type="checkbox"/> kategoria III <input type="checkbox"/> 2 pikë c) Mësues specialist <input type="checkbox"/> kategoria II <input type="checkbox"/> 3 pikë d) Mësues mjeshër <input type="checkbox"/> kategoria I <input type="checkbox"/> 4 pikë</p> <p>Nëse kandidati zotëron edhe provimin e licencimit, edhe kategorinë e kualifikimit, vlerësohet për të dy treguesit.</p>	0-4 pikë
3	<p>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja:</p> <p>a) <input type="checkbox"/> Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike <input type="checkbox"/> 2 pikë. b) <input type="checkbox"/> Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B1 <input type="checkbox"/> 2 pikë. c) <input type="checkbox"/> Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar nivel B2 <input type="checkbox"/> 4 pikë.</p> <p>Si gjuhë e huaj e mbrojtur llogaritet edhe rasti kur gjuha e huaj është e mbrojtur në kuadër të përfundimit të studimeve universitare të ciklit të dytë, sipas legjislacionit përkatës.</p> <p>Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t'i llogariten më shumë se 4 pikë në vlerësimin e dosjes.</p> <p>Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t'i llogariten pikë vetëm për një dëshmi.</p> <p>Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.</p>	0-4 pikë
4	<p>Certifikata trajnimesh:</p> <p>Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>a) <input type="checkbox"/> deri në 3 kredite <input type="checkbox"/> 1 pikë b) <input type="checkbox"/> mbi 3 kredite <input type="checkbox"/> 2 pikë</p>	0-2 pikë
5	<p>Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve.</p> <p>Përfaqësuesit e prindërve të nxënësve, ku mësuesi jep mësim, vlerësojnë me pyetësor punën e këtij mësuesi me nivelet: "Sh. Mirë", "Mirë", "Mjaftueshëm", "Dobët".</p> <p>Vlerësimi "Sh. mirë" dhe "Mirë" = 2 pikë Vlerësimi "Mjaftueshëm" <input type="checkbox"/> 1 pikë Vlerësimi "Dobët" <input type="checkbox"/> 0 pikë</p>	0-2 pikë
6	<p>Vlerësimi i psikologut dhe i punonjësit social të institucionit arsimor</p>	0-2 pikë
7	<p>Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, bazuar në vlerësimin e performancës, e shprehur në nivelet: "Sh. Mirë", "Mirë", "Mjaftueshëm", "Dobët".</p> <p>Vlerësimi: "Sh. mirë" dhe "Mirë" <input type="checkbox"/> 2 pikë Vlerësimi: "Mjaftueshëm" <input type="checkbox"/> 1 pikë Vlerësimi: "Dobët" <input type="checkbox"/> 0 pikë</p>	0-2 pikë



SHTOJCA 3
FORMULAR I PJESË MARRJES NË TESTIMIN E INFORMATIZUAR

DRAP:
 EMRI, ATËSIA, MBIEMRI:
 ID:
 PROFILI:
 PIKËT E DOSJES:
 PIKËT E TESTIMIT në rastet kur i mbart:

ZVA KU KËRKON TË PUNËSOHET:

1.
2.
3.

PËR KOMISIONIN E VLERËSIMIT TË DOSJEVE

KRYETARI

DREJTORI DRAP

Emër, mbiemër, firma, vula

SHTOJCA 4

KËRKESË PËR KONKURRIM NË PORTALIN “MËSUES PËR SHQIPËRINË”

Unë kërkoj të marr pjesë në konkurrimin “Mësues për Shqipërinë” për vitin shkollor - në DRAP/DPAP .

Kërkesa për konkurrim bëhet për njërin nga rastet e mëposhtme:

- a Aplikoj për herë të parë.
- b Mbart pikët aktuale dosje + testim
- c Mbart vetëm pikët e dosjes.
- d Mbart vetëm pikët e testimit të fundit.

Kërkoj të konkurroj dhe të renditem për punësim në këto ZVAP:

1.
2.
3.

Tel.: e-mail:

Emër, atësi, mbiemër

Nënshkrimi



SHTOJCA 5

DEKLARIMI I GJENDJES GJYQSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër:

Datëlindja:

Vendlindja:

Dokumenti i identifikimit Kopje bashkëlidhur formularit

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam:

i/e padënuar

i/e dënuar

Emër, mbiemër: Nënshkrimi:

Autorizim: Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 8517, datë 22.07.1999, "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

SHTOJCA 6

DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË
PARAQITURA NGA KANDIDATI

Unë , kandidat në procesin e konkurrimit për lëndën/profilin " _____", të zhvilluar në vitin shkollor -, autorizoj DRAP të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

AUTORIZUESI



URDHR

Nr. 100, datë 10.04.2019

PËR SHPALLJE E RYSHIMEVE TË STANDARDIT KOMBËTAR TË KONTABILITETIT

1.000,100001000
 0,11,00010,
 KOMBËTAR TË KONTABILITETIT R
 000,9000000000,00
 0020000,000010,
 KOMBËTAR TË KONTABILITETIT
 1000000,0,0,0,0,100
 STANDARDIT KOMBËTAR TË
 210,000,1000000,900
 BIOLOGJIKË HE MARRËESHJET
 2100,21000
 300,000

Në mbështetje të nenit 3, pika 5, të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, të nenit 11, pika 4 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 672, datë 26.10.2005 “Për miratimin e rregullores së brendshme të

organizimit dhe funksionimit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit”

URDHRORJ:

1. Shpalljen e disa ndryshimeve të Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 3 “Instrumentet financiare” (SKK 3), Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe jomateriale” (SKK 5), Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 11 “Tatimi mbi fitimin” (SKK 11) dhe Standardit Kombëtar të Kontabilitetit nr. 13 “Aktivet biologjike dhe marrëveshjet koncesionare”, të përmirësuara.

2. Ndryshimet e SKK 3, SKK 5, SKK 11 dhe SKK 13, të përmirësuara, të publikuara në vitin 2019, kanë datë efektive 1 janar 2020 dhe do të zbatohen në perspektivë, pa kërkuar riparaqitjen e pasqyrave financiare të vitit të mëparshëm.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
 DHE EKONOMIS
 Anila Enaj

1.000,0000010000,1000010000,11,000
 I PËRMIRËSUAR

Paragrafët 46, 47, 48, 49, 50, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 77, 78, 79, 80, 81 dhe 82 janë shtuar të rinj. Përmbajtja dhe paragrafët 1, 2, 4, 83, 84 janë ndryshuar. Paragrafët 36, 44 dhe 45 janë fshirë. Teksti i shtuar është i nënvizuar, teksti i fshirë ka vizë në mes.

OBJEKTI I HE BAZAT E PËRATITJES

1. Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 3 (Strukturat e dëgjuesve) SKK 3 i përmirësuar miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të instrumenteve financiare si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit, të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përshkruhen në Ligjin nr. 922825/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004 maj 2018, i ndryshuar.

2. SKK 3 mbështetej në standardin ndërkombëtar të kontabilitetit SNK 32 (Strukturat e dëgjuesve) paraqitja dhe SNK 39 (Strukturat e dëgjuesve) bërë dhe atë. SKK 3 i përmirësuar është ndryshuar për t'u bërë i krahasueshëm me Seksionin 11 (Strukturat e dëgjuesve) dhe Seksionin 12 (Shtimi i dëgjuesve) të SNRF për NVM-të 2009. Një tabelë korresponduese e paragrafëve të SNRF për NVM-të 2009 është dhënë në paragrafin 4584. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 3 i përmirësuar ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që Faqe 5978



sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare të njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin 9-11 të Ligjit nr. 922825/2018: “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar maj 2018.

SEKSIONI 1 STRUMENTET FINANCIARE BAZË FUSHA E ZBATIMIT

4. Ky Standard Seksioni 1 i këtij Standardi do të zbatohet për kontabilizimin e instrumenteve të mëposhtme financiare:

a) mjetet monetare.

b) një instrument borxhi (logari, dëftesë ose hua e arkëtueshme ose e pagueshme) që plotëson kushtet në paragrafin 7.

c) një zotim për të marrë një hua e cila:

i) nuk mund të paguhet në para, dhe

ii) kur zotimi realizohet, pritet që ai të plotësojë kushtet e dhëna në paragrafin 7.

3-5 4,7-1 67580 179 1 1,5 1 3 64 5 7 1 1,5

36. Aktivitetet dhe detyrimet financiare, dhe të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura me to do të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e performancës, në përputhje me kërkesat e SKK 2

7 + 5 61 7,0

44. Ky Standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ky Standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive:

5 + 6,0, 0 67 1 5 7 1 5.20 7 5 7 5 3257,0,7

FIKSI PËR MËTË 2009

45. Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM-të përkatëse. Paragrafët janë trajtuar si korresponduese, nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje, pavarësisht nga fakti që përshkrimet në seksionet e referuara mund të kenë ndryshime.

SEKSIONI 2 ËSHTJE TË TJERA PËR I STRUMENTET FINANCIARE FUSHA E ZBATIMIT

46. Seksioni 2 zbatohet për instrumentet dhe transaksionet financiare të tjera më të ndërlikuara. Nëse një njësi ekonomike hyn në transaksione vetëm të instrumenteve financiare bazë të seksionit 1 atëherë seksioni 2 nuk është i zbatueshëm. Megjithatë, edhe njësitë ekonomike që përdorin vetëm instrumentet financiare bazë do të kenë parasysh objektin e seksionit 2 për t'u siguruar se ato janë të përjashtuar.

47. Seksioni 2 i këtij Standardi do të zbatohet edhe për investimet në aksione të preferuara të pakonvertueshëm dhe të pashitshëm dhe aksione të zakonshme të pashitshëm, që tregtohen publikisht ose vlera e drejtë e të cilëve, në të kundërt mund të matet në mënyrë të besueshme.

48. Seksioni 2 i këtij Standardi do të zbatohet për të gjitha instrumentet financiare, përveç sa më poshtë:

a) atyre që mbulohen nga seksioni 1.

b) interesave në filiale (shih SKK 9), interesat në pjesëmarrje dhe sipërmarrjet e përbashkëta (shih SKK 14)

c) të drejtat sipas kontratave të sigurimit përveç kontratës së sigurimit që mund të rezultojë në një humbje të të dyja palëve si rezultat i kushteve kontraktuale që nuk kanë lidhje me:

i) ndryshimet në rrezikun e siguruar

ii) ndryshimet në kursin e këmbimit të monedhave të huaja ose me

iii) një mosplotësim të detyrimit nga njëra prej palëve.

e) instrumentet financiare që plotësojnë përkufizimin e ‘kapitalit të vet’ të njësisë ekonomike

f) qiratë (shih SKK 7) përveç rastit kur qiraja mund të rezultojë në një humbje të qiradhënësit ose qiramarrësit si rezultat i kushteve kontraktuale që nuk kanë lidhje me:

i) ndryshimet në çmimin e aktivitetit të dhënë me qira

ii) ndryshimet në kurset e këmbimit të monedhave të huaja ose me

iii) një mosplotësim të detyrimit nga njëra prej palëve



g kontratat për shuma të kushtëzuara në një kombinim biznesi [shih SKK 9]. Ky përjashtim vlen vetëm për blerësin.

49. Shumica e kontratave për të blerë ose shitur një element jo-financiar të tillë si një mall, inventar, ose aktive afatgjata materiale, janë të përjashtuara nga ky seksion, sepse këta elementë nuk janë instrumente financiare. Megjithatë, ky seksion zbatohet për të gjitha kontratat që i kalojnë rreziqet mbi blerësit apo shitësit, të cilat nuk janë tipike të kontratave për të blerë ose shitur aktive materiale. Për shembull, ky seksion zbatohet për kontratat që mund të rezultojnë në një humbje të blerësit ose shitësit si rezultat i kushteve kontraktuale që nuk kanë lidhje me ndryshimet në çmimin e elementit jofinanciar, ndryshimet në kursin e këmbimit të monedhave të huaja, ose me një mosplotësim të detyrimit nga njëra palë.

50. Përveç kontratave të përshkruara në paragrafin 49, ky seksion zbatohet për kontratat e blerjes apo shitjes të elementeve [zërave] jo-financiare, nëse kontrata mund të shlyhet neto në para ose në një instrument financiar tjetër, ose me shkëmbimin e instrumenteve financiare sikur kontratat të ishin instrumente financiare, me përjashtim të: kontratave, që lidhen dhe vazhdojnë të mbahen për qëllime të marrjes ose ofrimit të një zëri jo-financiar në përputhje me blerjen e pritshme, shitjen apo kërkesat e përdorimit që ka njësi ekonomike, të cilat nuk janë instrumente financiare për qëllime të këtij seksioni.

JOHJA HE MATJA

jja

51. Një njësi ekonomike duhet të njohë një aktiv financiar ose një detyrim financiar vetëm kur njësi ekonomike bëhet palë në kushtet kontraktuese të instrumentit.

Matja

52. Një njësi ekonomike, kur njeh një aktiv ose detyrim financiar sipas seksionit 2, duhet ta matë atë me vlerën e drejtë, e cila është zakonisht çmimi i transaksionit.

erë imi i mëaëm

53. Në fund të çdo periudhe raportimi, një njësi ekonomike duhet të matë të gjitha instrumentet financiare që janë objekt i seksionit 2 me vlerën e drejtë dhe të njohë ndryshimet në vlerën e drejtë në fitim ose humbje, përveç: instrumenteve të kapitalit që nuk tregtohen publikisht dhe vlera e drejtë e të cilave nuk mund të matet ndryshe në mënyrë të besueshme, si dhe kontratave të lidhura me instrumente të tillë që, nëse ushtrohen, do të rezultojnë në dhënien e këtyre instrumenteve, të cilat do të maten me koston pakësuar me shumën e zhvlerësimit.

54. Nëse një matje e besueshme e vlerës së drejtë nuk është më e disponueshme për një instrument kapitali që nuk tregtohet publikisht, por matet me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, vlera e drejtë në datën e fundit që instrumenti ka qenë i matshëm në mënyrë të besueshme, trajtohet si kosto e instrumentit. Njësi ekonomike do të vlerësojë këtë instrument me shumën e koston së tij pakësuar me zhvlerësimin deri sa një matje e besueshme e vlerës së drejtë të jetë e disponueshme.

55. Një investim të aksione të zakonshme ose të preferuara matet me vlerën e drejtë nëse vlera e drejtë e aksioneve mund të matet në mënyrë të besueshme. Një njësi duhet të përdorë hierarkinë vijuese për të vlerësuar vlerën e drejtë të aksioneve:

a Evidenca më e mirë e vlerës së drejtë është çmimi i kuotuar për një aktiv të ngjashëm në një treg aktiv. Ky është zakonisht çmimi aktual i ofertës

b Kur çmimet e kuotuar janë të padisponueshme, çmimi i një transaksioni të kohëve të fundit për një aktiv të ngjashëm siguron evidencë për vlerën e drejtë, për sa kohë nuk ka pasur ndonjë ndryshim domethënës në rrethanat ekonomike ose një kalim domethënës i kohës që kur ka ndodhur transaksioni. Nëse njësi mund të tregojë që çmimi i transaksionit të fundit nuk është një vlerësim i mirë i vlerës së drejtë [psh sepse ai reflekton vlerën që një njësi do të merrte ose paguante në një transaksion të detyruar, likuidim jo vullnetar ose shitje në gjendje të vështirë], ky çmim rregullohet.

c Nëse tregu për aktivin nuk është aktiv dhe transaksionet e kohëve të fundit për llogari të tyre për një aktiv të ngjashëm nuk janë një vlerësim i mirë i vlerës së drejtë, një njësi vlerëson vlerën e drejtë duke përdorur një teknikë vlerësimi. Objektivi i përdorimit të një teknike vlerësimi është për të vlerësuar çfarë çmimi do të kishte qenë në datën e matjes në një shkëmbim me vullnet të lirë të



motivuar nga konsideratat normale të biznesit.

Udhëzimet për teknikat e vlerësimit të vlerës së drejtë jepen në paragrafët 56-63.

që vlerën e drejtë të teknikat e vlerësimit

56. Teknikat e vlerësimit përfshijnë përdorimin, nëse është e disponueshme, të referencave të transaksioneve me vullnet të lirë të kohëve të fundit për një aktiv të ngjashëm mes palëve në dijeni, me vullnet të lirë, për vlerën e drejtë të një aktivi tjetër që është në thelb i njëjtë si aktivi që po matet, me analizat e flukseve të mjeteve monetare dhe modeleve të vlerësimit të opsioneve. Nëse ka një teknikë vlerësimi gjerësisht të përdorur nga pjesëmarrësit e tregut për t'i vendosur një çmim aktiviteti dhe kjo metodë ka treguar që siguron vlerësime të besueshme të çmimeve të përfutuara në transaksionet aktuale të tregut, njësi përdor atë teknikë.

57. Objektivi i përdorimit të një teknike vlerësimi është të vendoset çfarë çmimi do të kishte qenë në datën e matjes në një transaksion të kryer në mënyrë të vullnetshme mes palëve të palidhura me njëra-tjetrën, të motivuara nga shumatat normale të biznesit. Vlera e drejtë vlerësohet në bazë të rezultateve të një teknike vlerësimi që përdor maksimumin e inputeve të tregut dhe mbështetet sa më pak të jetë e mundur inputet e vendosura në njësi. Një teknikë vlerësimi pritet të arrijë një vlerësim të besueshëm të vlerës së drejtë nëse:

a) ajo paraqet në mënyrë të arsyeshme sesi tregu pritet t'i caktojë një çmim aktiviteti; dhe

b) inputet për vlerësimin teknik përfaqësojnë në mënyrë të arsyeshme pritshmërinë dhe matjet e faktorëve të riskut të kthimit thelbësorë në aktiv.

Tre gjëra të rëndësishme të vlerësimit

58. Vlera e drejtë e investimeve në aktive që nuk kanë një çmim tregu të kuotuar, në një treg aktiv, është i matshëm në mënyrë të besueshme nëse:

a) ndryshueshmëria në shtrirjen e vlerësimit të arsyeshëm të vlerës së drejtë nuk është domethënëse për atë aktiv ose

b) probabilitetet e vlerësimeve të ndryshme brenda shtrirjes mund të maten në mënyrë të arsyeshme dhe të përdoren në vlerësimin e vlerës së drejtë.

59. Ka shumë situata në të cilat ndryshueshmëria në shtrirjen e vlerësimeve të arsyeshme të vlerës së drejtë të aktiveve që nuk kanë një çmim tregu të kuotuar, është e mundshme të mos jetë domethënëse. Normalisht është e mundur për të vlerësuar vlerën e drejtë të një aktivi që një njësi ekonomike ka blerë nga një palë e jashtme. Gjithsesi, nëse shtrirja e vlerësimit të arsyeshëm të vlerës së drejtë është domethënëse dhe probabilitetet e vlerësimeve të ndryshme nuk janë të matshme në mënyrë të arsyeshme, njësisë matja e aktivitetit në vlerën e drejtë.

60. Nëse një matje e besueshme e vlerës së drejtë nuk është më e disponueshme për një aktiv të matur në vlerën e drejtë (p.sh. një instrument kapitali i matur me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes), vlera e tij kontabël në datën e fundit në të cilën aktivi ishte i matshëm në mënyrë të besueshme bëhet kosto e tij e re. Njësi duhet të masë aktivin me këtë kosto minus zhvlerësimin derisa bëhet e disponueshme një matje e besueshme e vlerës së drejtë.

61. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë udhëzimet mbi vlerën e drejtë të dhëna në paragrafët 56-60 për matjen e vlerës së drejtë në përputhje me këtë seksion.

62. Vlera e drejtë e një detyrimi financiar që është i pagueshëm kundrejt kërkesës nuk duhet të jetë më e vogël se shuma e pagueshme kundrejt kërkesës, e skontuar që nga data e parë që shuma mund të kërkohej të paguhet.

63. Një njësi ekonomike nuk do të përfshijë shpenzimet e transaksionit në matjen fillestare të aktiveve dhe detyrimeve financiare që do të maten më vonë me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Nëse pagesa për një aktiv është shtyrë ose është financiar me një normë interesi që nuk është një normë e tregut, njësi ekonomike, fillimisht, do të matë aktivin me vlerën aktuale të pagesave të ardhshme të skontuar me normën e tregut të interesit.



ZHVLERËSIMI I INSTRUMENTEVE FINANCIARE TË MATURA ME KOSTO OSE KOSTO TË AMORTIZUAR

64. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë udhëzimet për zhvlerësimin e një instrumenti financiar të matur me kosto, të dhëna në paragrafët 22-27 për instrumentet financiare të matura me koston e pakësuar me zhvlerësimin në përputhje me këtë seksion.

REGJISTRIMI I JË AKTIVITETIT FINANCIAR OSE DETYRIMI FINANCIAR

65. Një njësi ekonomike duhet të zbatojë kërkesat e çregjistrimit të dhëna në paragrafët 28-30 dhe 33-35 për aktivet dhe detyrimet financiare për të cilat zbatohet ky seksion.

KONTABILITETI MBROJTËS

66. Nëse plotësohen kriteret e specifikuara, një njësi ekonomike mund të caktojë një marrëdhënie mbrojtëse midis një instrumenti mbrojtës dhe një zëri të mbrojtur në mënyrë të tillë, që të kualifikohet për kontabilitetin mbrojtës. Kontabiliteti mbrojtës lejon që fitimi ose humbja në instrumentin mbrojtës dhe në zërin e mbrojtur, të njihet në fitim ose humbje në të njëjtën kohë.

67. Për t'u kualifikuar për kontabilitetin mbrojtës, një njësi ekonomike duhet të plotësojë të gjitha kushtet e mëposhtme:

njësi ekonomike përcakton dhe dokumenton marrëdhënien mbrojtëse në të cilën rreziku që duhet mbrojtur, zëri i mbrojtur dhe instrumenti mbrojtës, janë të identifikuar qartazi dhe rreziku në zërin e mbrojtur është rreziku që mbrohet me instrumentin mbrojtës

rreziku i mbrojtur është një nga rreziqet e specifikuar në paragrafin 68

instrumenti mbrojtës është specifikuar në paragrafin 70

njësi ekonomike pret që instrumenti mbrojtës të jetë tepër efektiv në kompensimin e rrezikut të caktuar i mbrojtur.

Efektiviteti i një mbrojtjeje është shkalla në të cilën ndryshimet në vlerën e drejtë ose rrjedhën e parave të zërit të mbrojtur që i atribuohen rrezikut të mbrojtur kompensohen nga ndryshimet në vlerën e drejtë ose rrjedhën e parave të instrumentit mbrojtës.

68. Ky seksion lejon kontabilitetin mbrojtës vetëm për rreziqet e mëposhtme:

rrezikun e normës së interesit të një instrumenti borxhi të matur me kosto të amortizuar

rrezikun e këmbimit valutor ose të normës së interesit në një angazhim të përcaktuar apo të një transaksioni parashikues me probabilitet të lartë

rrezikun e çmimit të një malli që mbahet, ose në një angazhim të përcaktuar ose transaksion parashikues me probabilitet të lartë për të blerë ose shitur një mall

rrezikun e këmbimit të monedhave të huaja në një investim neto në një operacion të huaj.

69. Rreziku i këmbimit të monedhave të huaja për një instrument borxhi të matur me kosto të amortizuar nuk është në listën e mësipërme të kontabilitetit mbrojtës, sepse nuk do të kishte ndonjë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare. Instrumentet financiare bazë, dëftesat e borxhit dhe huatë e arkëtueshme / të pagueshme zakonisht maten me kosto të amortizuar (shih paragrafin 5 d). Kjo do të përfshijë detyrimet e përcaktuara në një monedhë të huaj. Paragrafi 15 në SKK 12 (akti i dritshimit) kursit të këmbimit i kërkon që çdo ndryshim në vlerën kontabël neto të llogarisë së pagueshme për shkak të një ndryshimi në kursin e këmbimit të njihet në fitim ose në humbje. Prandaj, si ndryshimi në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës (kontrata e ndër-shkëmbimit të monedhave) dhe ndryshimi në vlerën kontabël neto të llogarive të pagueshme në lidhje me ndryshimin e kursit të këmbimit, do të njihen në fitim ose humbje dhe duhet të kompensojnë njëri-tjetrin, përveçse deri në masën e diferencës midis normës së çastit në të cilën detyrimi është i matur dhe normës së ardhshme në të cilën është matur kontrata e shkëmbimit.

70. Ky seksion lejon kontabilitetin mbrojtës vetëm në qoftë se instrumenti mbrojtës plotëson të gjitha termat dhe kushtet në vijim:

është një kontratë për norma interesi swap, një kontratë swap e këmbimit të monedhave të huaja, një kontratë e ardhshme këmbimi e monedhave të huaja, ose një kontratë e ardhshme këmbimi të mallrave që pritet të jetë shumë efektive në kompensimin e një rreziku të identifikuar në paragrafin 67 që është përcaktuar si rrezik i mbrojtur.



përfshin një palë të jashtme në lidhje me njësinë raportuese ndërmth. e jashtme me grupin, segmentin apo njësinë ekonomike të veçantë për të cilën raportohet.

shumën e imagjinar e tij është e barabartë me shumën e caktuar të principalit apo shumën e imagjinar të zërit të mbrojtur.

ka një datë të caktuar maturimi jo më vonë se:

maturimi i instrumentit financiar të mbrojtur,

shlyerja e prituri e angazhimit në blerjen ose shitjen e mallrave, apo

ndodhja e transaksionit parashikues me probabilitet të lartë të monedhës së huaj ose të mallit që është i mbrojtur.

nuk ka parapagim, ndërprerje të hershme ose zgjerim të karakteristikave.

Mbrojtja e rrethimit të normës së interesit të një instrumenti financiar të njëri rrethimit të mimit të një malli të mbajtur

71. Në qoftë se kushtet e dhëna në paragrafin 67 janë përmbushur dhe rreziku i mbrojtur është ekspozimi ndaj një rreziku në normën fikse të interesit të një instrumenti borxhi të matur me kosto të amortizuar, ose rrezikut të çmimit të një malli që mbahet, njësia ekonomike do të:

njohë instrumentin mbrojtës si një aktiv ose detyrim dhe ndryshimin në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës në fitim ose humbje, dhe

njohë ndryshimin në vlerën e drejtë të zërit të mbrojtur lidhur me rrezikun e mbrojtur, në fitim ose humbje dhe si një rregullim të vlerës kontabël neto të zërit të mbrojtur.

72. Nëse rreziku i mbrojtur është rreziku i normës fikse të interesit të një instrumenti borxhi të matur me kosto të amortizuar, njësia ekonomike do të njohë shlyerjet periodike neto në para të kontratës së këmbimit të normave të interesit, që është instrument mbrojtës, në fitim ose humbje në periudhën në të cilën shlyerjet neto konstatohen.

73. Njësia ekonomike do të ndërpresë kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafin 71 nëse:

instrumentit mbrojtës i ka mbaruar afati ose është shitur ose ndërprerë.

mbrojtja nuk i plotëson kushtet për kontabilitetin mbrojtës, të specifikuar në paragrafin 67 ose

njësia ekonomike heq dorë nga përcaktimi.

74. Nëse kontabiliteti mbrojtës është ndërprerë dhe zëri i mbrojtur është një aktiv ose detyrim me kosto të amortizuar që nuk është çregjistruar, çdo fitim apo humbje e njohur si rregullim i vlerës kontabël neto të zërit të mbrojtur amortizohet në fitim ose humbje duke përdorur metodën efektive të interesit mbi jetën e mbetur të instrumentit të mbrojtur.

Mbrojtja e rrethimit të normës së interesit të një instrumenti financiar të njëri rrethimit të çmimit të monedhës së huaja, ose rrethimit të mimit të mallrave në një anëtarim të përfaqësuar nga transaksionet e paraqitura me rrethimit të artë, ose një instrumenti neto në një seri të tilla

75. Në qoftë se kushtet e dhëna në paragrafin 67 janë përmbushur dhe rreziku i mbrojtur është:

rrezik i normës variabël të interesit të një instrumenti borxhi të matur me kosto të amortizuar,

rrezik i këmbimit të monedhave të huaja në një angazhim të përcaktuar apo i një transaksioni parashikues me probabilitet të lartë,

rrezik i çmimit të mallrave në një angazhim të përcaktuar ose i transaksionit parashikues me probabilitet të lartë, ose

rrezik i këmbimit të monedhave të huaja në një investim neto në një operacion të huaj,

atëherë njësia ekonomike do të njohë në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse pjesën e ndryshimit në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës që ishte efektive në kompensimin e ndryshimit në vlerën e drejtë ose të rrjedhjeve monetare të pritshme të zërit të mbrojtur. Njësia ekonomike do të njohë në fitim ose në humbje çdo tejkalim të vlerës së drejtë të instrumentit mbrojtës mbi ndryshimin në vlerën e drejtë të rrjedhjeve monetare të pritshme të quajtur nganjëherë joefektivitet i mbrojtjes. Fitimi ose humbja e mbrojtjes, e njohur në të ardhurat e tjera gjithpërfshirëse do të riklasifikohet në fitim ose humbje kur zëri i mbrojtur njihet në fitim ose humbje, ose kur përfundon marrëdhënia mbrojtëse.

76. Nëse rreziku i mbrojtur është rreziku i normës variabël të interesit në një instrument borxhi të



matur me koston e amortizuar, njësia ekonomike më pas do të njohë në fitim ose në humbje shlyerjet neto periodike në para të normave të interesit të kontratës swap që është instrument mbrojtës në periudhën në të cilën konstatohen shlyerjet neto.

77. Njësia ekonomike do të ndërpresë kontabilitetin mbrojtës të specifikuar në paragrafin 75 nëse:

a instrumentit mbrojtës i ka mbaruar afati ose është shitur apo ndërprerë

b mbrojtja nuk i plotëson kushtet për kontabilitetin mbrojtës, të specifikuara në paragrafin 67

c në një mbrojtje të një transaksioni parashikues me probabilitet të lartë, transaksioni parashikues nuk është më me probabilitet të lartë ose

d njësia ekonomike heq dorë nga ky klasifikim të përcaktim

Nëse transaksioni parashikues nuk pritet të ndodhë apo nëse instrumenti i borxhit i mbrojtur i matur me koston e amortizuar është çregjistruar, çdo fitim ose humbje e instrumentit mbrojtës që është njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, do të riklasifikohet nga të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse në fitim ose humbje.

SHËNIMET SHPJEGËSE PËR INSTRUMENTET E TJERA FINANCIARE

78. Një njësi ekonomike duke zbatuar këtë seksion do të japë të gjitha informacionet shpjeguese të kërkuara në seksionin 1 duke përfshirë në këto shpjegime instrumentet financiare që janë brenda objektit të këtij seksioni, si dhe ato që janë brenda objektit të seksionit 1. Përveç kësaj, në qoftë se njësia ekonomike përdor kontabilitetin mbrojtës, ajo do të japë informacione shpjeguese shtesë sipas paragrafëve 79-81.

79. Një njësi ekonomike duhet të japë informacionin shpjegues në vijim veçmas për secilin prej katër llojeve të rreziqeve të përshkruara në paragrafin 68:

a një përshkrim të mbrojtjes

b një përshkrim të instrumenteve financiare të përcaktuara si instrumente mbrojtës dhe vlerat e tyre të drejta në datën e raportimit

c natyrën e rreziqeve që mbrohen, duke përfshirë një përshkrim të zërit të mbrojtur.

80. Nëse një njësi ekonomike përdor kontabilitetin mbrojtës për një mbrojtje ndaj rrezikut të normës fikse të interesit ose rrezikut të çmimit për një mall të mbajtur në paragrafët 71-74 ajo do të japë informacionin shpjegues në vijim:

a shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës të njohur në fitim ose humbje.

b shumën e ndryshimit në vlerën e drejtë të instrumentit të mbrojtur të njohur në fitim ose humbje.

81. Nëse një njësi ekonomike përdor kontabilitetin mbrojtës për një mbrojtje të rrezikut të normës variabël të interesit, rrezikut të këmbimit të monedhave të huaja, rrezikut të çmimit të mallrave në një angazhim të përcaktuar apo transaksion parashikues me probabilitet të lartë, ose të një investimi neto në një operacion të huaj në paragrafet 75-77 ajo do të japë informacion shpjegues për sa vijon:

a periudhat kur pritet të ndodhin rrjedhjet e mjeteve monetare dhe kur ato pritet të ndikojnë në fitim ose humbje

b një përshkrim të çdo transaksioni parashikues për të cilin ishte përdorur më parë kontabiliteti mbrojtës, por i cili nuk pritet më të ndodhë

c madhësinë e ndryshimit në vlerën e drejtë të instrumentit mbrojtës që është njohur në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse gjatë periudhës në paragrafi 75

d shumën që riklasifikohet nga të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në fitim apo humbje për periudhën në paragrafet 75-77

e madhësinë e çdo tejkalimi të vlerës së drejtë të instrumentit mbrojtës mbi ndryshimin në vlerën e drejtë të rrjedhave të pritshme të mjeteve monetare që është njohur në fitim ose humbje në paragrafi 72

3 5 4, 7 - 1, 6 7 5 8 0 1 7 9 1, 1, 5 1 3 6 4 5 7 1, 1, 5

82. Aktivitetet dhe detyrimet financiare, dhe të ardhurat dhe shpenzimet e lidhura me to do të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në pasqyrën e performancës, në përputhje me kërkesat e SKK 2



7 + 5 - 6 1 7,0

83. Ky Standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ndryshimet e këtij Standardi do të zbatohen në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat kontabël që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2020. Ky Standard duhet të zbatohet në mënyrë prospektive. Ndryshimet me datë efektive 1 janar 2020 do të zbatohen në mënyrë prospektive.

KRAHASIMI ME SË RFPËR MË TË 2009

84. Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM-të përkatëse. Paragrafët janë trajtuar si korresponduese, nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje, pavarësisht nga fakti që përshkrimet në seksionet e referuara mund të kenë ndryshime.

Paragrafët sipas SKK 3	Paragrafët sipas SNRF për NVM 2009
<u>Paragrafi 36</u>	<u>Asnjë</u>
<u>Paragrafi 44</u>	<u>Asnjë</u>
<u>Paragrafi 45</u>	<u>Asnjë</u>
<u>Paragrafi 46</u>	<u>Sek 12.1</u>
<u>Paragrafi 47</u>	<u>Asnjë</u>
<u>Paragrafi 48</u>	<u>Sek 12.3</u>
<u>Paragrafi 49</u>	<u>Sek 12.4</u>
<u>Paragrafi 50</u>	<u>Sek 12.5</u>
<u>Paragrafi 51</u>	<u>Sek 12.6</u>
<u>Paragrafi 52</u>	<u>Sek 12.7</u>
<u>Paragrafi 53</u>	<u>Sek 12.8</u>
<u>Paragrafi 54</u>	<u>Sek 12.9</u>
<u>Paragrafi 55</u>	<u>Sek 11.27</u>
<u>Paragrafi 56</u>	<u>Sek 11.28</u>
<u>Paragrafi 57</u>	<u>Sek 11.29</u>
<u>Paragrafi 58</u>	<u>Sek 11.30</u>
<u>Paragrafi 59</u>	<u>Sek 11.31</u>
<u>Paragrafi 60</u>	<u>Sek 11.32</u>
<u>Paragrafi 61</u>	<u>Sek 12.10</u>
<u>Paragrafi 62</u>	<u>Sek 12.11</u>
<u>Paragrafi 63</u>	<u>Sek 12.12</u>
<u>Paragrafi 64</u>	<u>Sek 12.13</u>
<u>Paragrafi 65</u>	<u>Sek 12.14</u>
<u>Paragrafi 66</u>	<u>Sek 12.15</u>
<u>Paragrafi 67</u>	<u>Sek 12.16</u>
<u>Paragrafi 68</u>	<u>Sek 12.17 (Paragrafi i parë)</u>
<u>Paragrafi 69</u>	<u>Sek 12.17 (Paragrafi i dytë)</u>
<u>Paragrafi 70</u>	<u>Sek 12.18</u>
<u>Paragrafi 71</u>	<u>Sek 12.19</u>
<u>Paragrafi 72</u>	<u>Sek 12.20</u>
<u>Paragrafi 73</u>	<u>Sek 12.21</u>
<u>Paragrafi 74</u>	<u>Sek 12.22</u>
<u>Paragrafi 75</u>	<u>Sek 12.23</u>
<u>Paragrafi 76</u>	<u>Sek 12.24</u>
<u>Paragrafi 77</u>	<u>Sek 12.25</u>
<u>Paragrafi 78</u>	<u>Sek 12.26</u>
<u>Paragrafi 79</u>	<u>Sek 12.27</u>
<u>Paragrafi 80</u>	<u>Sek 12.28</u>
<u>Paragrafi 81</u>	<u>Sek 12.29</u>
<u>Paragrafi 82</u>	<u>Asnjë</u>



1 5 6+, 0 7 6. . . 7, 9 7 7 - 7 0 7 5, / + -2 0 7 5, /

I PËRMIRËSUAR

Paragrafët 1, 2, 18, 52 dhe 116 janë ndryshuar. Teksti i shtuar është i nënvizuar, teksti i fshirë ka vizë në mes.

OBJEKTI I HE BAZA E PËR ATITJES

1. Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 5 *aktiva dhe pasiv* (SKK 5 i përmirësuar), miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëposhëm të aktiveve afatgjata materiale dhe aktiveve afatgjata jomateriale si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përshkruhen në Ligjin nr. 9-228, datë 29.04.2004²⁵, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” publikuar në prill 2004, i ndryshuar maj 2018.

2. SKK 5 mbështetet në një numër standardesh ndërkombëtare të kontabilitetit, përfshirë SNK 16 *aktiva*, SNK 38 *aktiva*, SNK 36 *humbjet e aktiva*, SNK 23 *pasiv* dhe SNRF 5 *aktiva të përdorura për shiti dhe rrahe të shkurtra* SKK i përmirësuar **KUK USU EU LUK HKP PHIRIQ** *Aktiva afatgjata materiale të infektuar*, **Seçimi 1 Të, të dërta, Makineri dhe Pajisje**, **Seçimi 1 Aktiva afatgjata materiale të rrethimit të mirë**, **Seçimi 2 Kërkimet e amarrje**, **Seçimi 2 Zërrëimi i aktiveve**, të Standardeve të dërmëtare të Rërtimit Financiar të M të 2009. Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM 2009, është dhënë në paragrafin 117. Për rastet, të cilat nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 5 e përmirësuar ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësive ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe të ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare dhe të kapitalit të njësive ekonomike, siç kërkohet në nenin 9-11 të Ligjit nr. 922825, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar maj 2018.

erëimi i mëaëm

18. Njësia ekonomike do të zgjedhë si politikë të saj kontabël modelin e kostos i cili shpjegohet në paragrafin 19, ose modelin e rivlerësimit i cili shpjegohet në paragrafët 20-28 dhe do të zbatohet atë model për të gjithë klasën e AAM-ve që vlerësohet. Modeli i rivlerësimit nuk kërkohet të zbatohet nga njësitë ekonomike të vogla.

TRAJTIMI KO TABËL PËR AKTI ET AFAT JATA TË I ESTUARA

erëimi i mëaëm

52. Aktiv i afatgjatë i investuar, vlera e drejtë e të cilit të mund të matet në mënyrë të besueshme, pa kosto apo përpjekje të panevojshme, do të matet me vlerën e drejtë në çdo datë raportimi dhe ndryshimet në vlerën e drejtë njihen në fitim ose humbje. Nëse një interes mbi një pasuri të mbajtur sipas një kontrate qiraje është klasifikuar si aktiv afatgjatë i investuar, zëri i kontabilizuar me vlerën e drejtë është ky interes dhe jo pasuria bazë. Një njësi ekonomike duhet të trajtojë të gjitha aktivet e tjera të investuara si toka, ndërtesa, makineri dhe pajisje duke përdorur modelin kosto-amortizim-zhvlerësim.

Përjaftim e një ite e nmi e të a të i at in raj en r n anë det rimin të at jnë m de in e erë ë drejtë në erë imin e a ti e e a at jata materia e të in e t ara

ATA E HYRJES Ë ZBATIM

116. Ky Standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ndryshimet e këtij Standardi do të zbatohen në pasqyrat financiare që mbulojnë periudhat kontabël që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2020. Ndryshimet me datë efektive 1 janar 2020 do të zbatohen në mënyrë prospektive.



1 5 6+, 0 7 6. . 7 7,0 , 0 , 7,0 ,1

I PËRMIRËSUAR

Paragrafët 1, 2, 4 dhe 42 janë ndryshuar. Teksti i shtuar është i nënvizuar, teksti i fshirë ka vizë në mes.

OBJEKTI I HE BAZAT E PËR ATITJES

1. Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 11 ~~atë i~~ ~~ti~~ SKK 11 i përmirësuar miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëposhëm të tatimit mbi fitimin si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimeve financiare të pranura në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përshkruhen në Ligjin nr. ~~9-228, datë 29.04.2004~~²⁵, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” publikuar në ~~prill 2004, i ndryshuar~~ maj 2018.

2. SKK 11 mbështetet në standardin ndërkombëtar të kontabilitetit SNK 12, “Tatimi mbi të ardhurat”. SKK 11 i përmirësuar është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 29 ~~atë i~~ ~~ti~~ të ardhurat të Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për NVM-të 2009. Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM 2009 është dhënë në paragrafin 43. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 11 i përmirësuar ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të parasë së njësisë ekonomike, siç kërkohet në nenin 9-11 të Ligjit nr. ~~9228, datë 29.04.2004~~²⁵ “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në ~~prill 2004, i ndryshuar~~ maj 2018.

FUSHA E ZBATIMIT

4. Ky Standard mbulon kontabilizimin e tatimit mbi fitimin. Ai i kërkon një njësie ekonomike të njohë pasojat tatimore aktuale dhe të ardhshme nga transaksionet dhe ngjarjet e tjera të njohura në pasqyrat financiare. Njësitë ekonomike të vogla inkurajohen por nuk janë të detyruara të zbatojnë kërkesat e këtij standardi për tatimin e shtyrë.

ATA E HYRJES Ë ZBATIM

42. Ky standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël, që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ky standard do të zbatohet në mënyrë prospektive. Ndryshimet kanë datë efektive 1 janar 2020 dhe zbatohen në mënyrë prospektive.



RYSHIME TË SKK 13

9,202 ,202 0 90000021 21 0

I PËRMIRËSUAR

Paragrafët 1, 2, 4, 5, 8, 9, 13, 15, 16, 29 dhe 34 janë ndryshuar. Teksti i shtuar është i nënvizuar, teksti i fshirë ka vizë në mes.

OBJEKTI I HE BAZAT E PËR ATITJES

1. Objektiv i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 13 *aktet biologjike dhe Marrëveshjet konçesionare* (SKK 13 i përmirësuar) miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministri i Financave, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëposhëm për aktivet biologjike dhe marrëveshjet konçesionare si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare, të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit bazohen në parimet e kontabilitetit dhe të raportimit financiar të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të cilave përshkruhen në Ligjin Nr. 9228-25 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar maj 2018.

2. SKK 13 mbështetej në SNK 41, *uësia*. SKK 13 i përmirësuar është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 34 *aktet biologjike dhe Marrëveshjet konçesionare* të SNRF për NVM 2009. Një tabelë korresponduese e paragrafëve të Standardit me paragrafë të SNRF për NVM-të 2009 është dhënë në paragrafin 35. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 13 i përmirësuar ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike raportuese duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit të aplikojnë politika të tilla që sigurojnë një pasqyrim të vërtetë e të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare së njësisë ekonomike raportuese, siç kërkohet në nenin 9-11 të Ligjit nr. 9228-25, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar maj 2018.

FUSHA E ZBATIMIT

4. Ky Standard do të zbatohet për:

a) aktivet biologjike përfshirë të gjitha aktivet biologjike, përveç tokave të përdorura për veprimtari bujqësore (shiko SKK 5, *aktet biologjike dhe Marrëveshjet konçesionare* dhe prodhimin bujqësor, i cili kontabilizohet si inventar që nga momenti i vjeljes përfundimit (shiko SKK 4, *aktet biologjike dhe Marrëveshjet konçesionare*), dhe

b) marrëveshjet konçesionare.

5. Më poshtë jepen përkufizimet e termave kryesore të përdorura në këtë standard:

Aktiviteti bujqësor është menaxhimi nga ana e një njësie ekonomike i transformimit biologjik të aktiveve biologjike në prodhim bujqësor për shitje ose në aktive të tjera biologjike.

Prodhimi bujqësor është prodhimi i vjelje përfunduar nga aktivet biologjike të njësisë ekonomike.

Aktivi biologjik është një kafshë e gjallë ose bimë.

Transformimi biologjik përfshin proceset e rritjes, shndërrimit, prodhimit dhe mbarështimit që sjellin ndryshime cilësore e sasiore në aktivin biologjik.

Vlera kontabël neto është shuma, me të cilën një aktiv biologjik njihet në pasqyrën e pozicionit financiar pasi zbritet amortizimi i akumuluar dhe humbjet e mundshme nga zhvlerësimi.

Amortizimi është shpërndarja sistematike e vlerës së amortizueshme të një aktivi biologjik, përgjatë jetës së tij të dobishme.

Vlera e amortizueshme është kostoja e një aktivi ose një vlerë tjetër që zëvendëson koston, minus vlerën e rikuperueshme të aktivit.

Jeta e dobishme është:

—periudha, gjatë së cilës një aktiv pritet të përdoret nga njësi ekonomike;

—numri i produkteve ose njësi të tjera të ngjashme që njësi ekonomike pret të përftojë nga përdorimi i aktivit.



Kostoja është shuma e mjeteve monetare ose ekuivalenteve të mjeteve monetare e paguar, ose vlera e drejtë e aktiveve të tjera të dhëna për të blerë një aktiv në kohën e blerjes apo të prodhimit të tij.

Vlera e rikuperueshme është shuma e vlerësuar që njësi ekonomike pret të përftojë nga një aktiv në fund të jetës së tij të dobishme, pas zbritjes së kostos së nxjerrjes nga përdorimi.

Humbja nga zhvlerësimi është shuma, me të cilën vlera kontabël e një aktivi ose një njësie gjeneruese parash e tejkalon shumën e tij të rikuperueshme.

Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktivi pakësuar me koston e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim.

Vlera në përdorim është vlera aktuale e flukseve të ardhshme të vlerësuara të mjeteve monetare, që pritet të vijë nga përdorimi i një aktivi ose nga dalja e tij jashtë përdorimit në fund të jetës së tij të dobishme.

Përitat nta ër a tlet i i jle

8. Një njësi ekonomike përdoruese e këtij që zbaton këtë standard standardi, që sepse është përfshirë në kryen aktivitetet bujqësor, duhet të përcaktojë politikën e saj kontabël për çdo klasë të aktiveve biologjike si më poshtë:

a) Njësia ekonomike duhet të përdorë modelin e vlerës së drejtë në paragrafët 12-14 për ato aktive biologjike për të cilat vlera e drejtë është menjëherë e përcaktueshme pa kosto apo përpjekje të tepërta.

b) Njësia ekonomike duhet të përdorë modelin e kostos në paragrafët 15-16 për gjithë aktivitetet e tjera biologjike.

Njësitë e vogla ekonomike inkurajohen por nuk janë të detyruara në zbatimin e pikës a të këtij neni. Këto njësi ekonomike përdorin modelin e kostos për të gjitha aktivitetet e tyre biologjike.

j ja ile tare

9. Një njësi ekonomike duhet të njohë një aktiv biologjik ose një produkt bujqësor vetëm kur:

a) njësia ekonomike kontrollon aktivin biologjik / produktin bujqësor si rezultat i ngjarjeve të kaluara.

b) është e mundshme që në njësinë ekonomike të hynë përfitime ekonomike të ardhshme të lidhura me aktivin biologjik / produktin bujqësor dhe

c) vlera e drejtë ose kosto e aktivit biologjik / produktit bujqësor mund të matet në mënyrë të besueshme pa kosto ose përpjekje të tepërta.

MATJA HE LERËSIMI I MËPASSHËM

Matja mde i erë ë drejtë

13. Produktet bujqësore të përftuara nga aktivitetet biologjike të një njësie ekonomike, duhet të maten në njohje me vlerën e drejtë minus koston e shitjes në kohën e vjeljes momentin e përftimit. Kjo vlerë e matur përbën koston në datën e përftimit, kur zbatohet SKK 4 tar t.

Matja mde i t

15. Njësia ekonomike mat me kosto minus çdo amortizim të akumuluar dhe çdo humbje nga zhvlerësimi i akumuluar, ato aktive biologjike vlera e drejtë e të cilëve nuk është menjëherë e përcaktueshme, pa kosto apo përpjekje shtesë.

16. Njësia ekonomike mat produktet bujqësore të siguruar nga aktivitetet e saj biologjike me vlerën e drejtë minus koston e shitjes në momentin e përftimit në kohën e vjeljes. Një matje e tillë përbën koston e produktit bujqësor në datën e matjes.

SHË IMET SHPJE UESE

Sënimet je e ër a tlet i i jle

A tlet i i jle të m ajt ra me erë të drejtë

29. Në pasqyrat financiare duhet të jepet informacioni i mëposhtëm, në lidhje me aktivitetet biologjike të matura me vlerën e drejtë:

a) një përshkrim të çdo klase të aktiveve të saj biologjike.

b) metodat dhe supozimet domethënëse të përdorura në përcaktimin e vlerës së drejtë të çdo



kategoritë të produkteve bujqësore në kohën e vjeljes momentin e përfundimit dhe çdo kategori të aktiveve biologjike.

ii) një rekordim të ndryshimeve në vlerën kontabël të aktiveve biologjike ndërmjet fillimit dhe fundit të periudhës aktuale. Rakordimi duhet të përfshijë:

i) fitimin ose humbjen që lind nga ndryshimet në vlerën e drejtë minus kostot e shitjes.

ii) rritjet që rezultojnë nga shitjet.

iii) rëniet që rezultojnë nga vjelja.

iv) ndryshime të tjera

ATA E HYRJES Ë ZBATIM

34. Ky standard do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ndryshimet kanë datë efektive 1 janar 2020 dhe do të zbatohen në prospektivë.

JOFTIM

19 shtatori, datë 21 shtatori 2019

**PËR HYRJE Ë FUQI TË JË
MARRË ESHJEJE ME KOSO Ë**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar, nënshkruar në Morinë, më 29.12.2018, ka hyrë në fuqi në datën 16.5.2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHM
I MINISTRIS PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
a mend Bar

JOFTIM

19 shtatori, datë 21 shtatori 2019

**PËR HYRJE Ë FUQI TË JË
MARRË ESHJEJE ME KOSO Ë**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për njohjen e ndërsjellë të patentë shoferëve/lejeve të drejtimit, nënshkruar në Pejë, më 26.11.2018, ka hyrë në fuqi në datën 16.5.2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHM
I MINISTRIS PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
a mend Bar

JOFTIM

19 shtatori, datë 23 shtatori 2019

**PËR HYRJE Ë FUQI TË JË
MARRË ESHJEJE ME FRA Ë**

Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Francës për punësimin me pagë të anëtarëve të familjeve të punonjësve të misioneve zyrtare të secilit shtet në shtetin tjetër, e nënshkruar në Tiranë, më 19.9.2016, hyn në fuqi në datën 19.6.2019.

SEKRETAR I PËRGJITHSHM
I MINISTRIS PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
a mend Bar

E IM

19 shtatori, datë 10 shtatori 2019

**MBI FILLIMI E PROJEKUT PËR
MIRATIMI E RAFTKO TRATËS TIP
PËR SHITBLERJE E EREJISË
ELEKTRIKE Ë ËRMJET SHOQËRISË
SË PROHIMIT TË EREJISË
ELEKTRIKE KESH SHA, AKSIONET E
SË ILËS KO TROLLOHE
PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT A
SHTETI HE FURIZUESIT TË
SHËRBIMIT U IERSALOSHEE SHA
PËR PERIU HË 13 2019 31 12 2019**

Në mbështetje të neneve 16, dhe 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 104, pika



4, germa “a”, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i procedurës Administrative”, nenet 5 dhe 14, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 26 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në lidhje me fillimin e procedurës “Për miratimin e draftkontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a. për periudhën 1.3.2019–31.12.2019”.

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 176/1 prot., datë 6.3.2019, ERE u ka kërkuar shoqërisë KESH sh.a., dhe OSHEE sh.a., duke venë në dijeni edhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, të depozitojnë kontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2019, si dhe kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit e shërbimit universal, në të kundërt ERE do të vendosë mbi hyrjen në fuqi të kontratës pa miratimin e palëve, gjë që vendos palët para detyrimit për zbatimin e saj brenda një afati 30-ditor.

- Me vendimin e bordit të ERE-s nr. 16, datë 18.2.2019 u vendos për shtyrjen e afatit të zbatimit të kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 98, datë

30.4.2018, deri në paraqitjen e draftkontratës për vitin 2019 nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. dhe miratimin e saj nga ERE.

- Shoqëria KESH sh.a., në vijim të korrespondencës së sipërcituar, ka përcjellë në ERE shkresën me nr. 1287/1 prot., datë 13.3.2019, protokolluar me tonën me nr. 176/2 prot., datë 15.3.2019, draftkontratën mes KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. “Për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe furnizuesit e shërbimit universal, për furnizimin e klientëve fundorë, për periudhën kohore 1.3.2019–31.12.2019”. Në këtë shkresë, KESH sh.a. ka kërkuar komentet paraprake, me qëllim që palët të vijnë me nënshkrimin përfundimtar të marrëveshjes, e cila do përcillet për miratim pranë ERE-s.

- Në vijim të sa më sipër ERE në shkresën e saj me nr. 176/3 prot., datë 29.3.2019 bëri me dije se, do të japë opinionin gjatë procedurës së shqyrtimit të kontratës së nënshkruar dhe shpreh qëndrimin e saj me vendim. Gjithashtu lidhur me këtë kërkesë, ERE bëri me dije se: neni 5, pika 2, i VKM-së me nr. 244, datë 30.6.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” përcakton se: sasia e energjisë elektrike përcaktohet në kontratën e rregulluar ndërmjet palëve, që miratohet nga ERE, bazuar në një regjim shfrytëzimi të kapaciteteve gjeneruese dhe një niveli historik mesatar vjetor të prodhimit. Në këto kushte nuk është e nevojshme të pritet për komente/sugjerime të ERE-s për të vijuar më tej me lidhjen e kontratës ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.. ERE me anë të kësaj shkrese ka kërkuar që të procedohet me dërgimin e kontratës së dakordësuar dhe të nënshkruar mes palëve, që më pas ERE të vijojë me shqyrtimin dhe dhënien e opinionit nëpërmjet vendimmarrjes.

- Me shkresën nr. 1716/1, prot., datë 8.4.2019, e KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. protokolluar me tonën me nr. 176/4 prot., datë 8.4.2019, shoqëria KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., i kanë përcjellë ERE-s për miratim



“Kontratën për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet Shoqërisë së Prodhimit të Energjisë Elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal/OSHEE sh.a. për periudhën 1.3.2019 – 31.12.2019” të nënshkruar nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a.

- Kjo kontratë paraqitet e strukturuar nga 23 pjesë të ndryshme dhe një shtojcë e cila ka të bëjë me termat e përdorura në këtë kontratë. Pjesë integrale e kësaj kontrate është edhe aneksi 1, i cili nëpërmjet tabelës përkatëse përcakton parashikimin e prodhimit nga KESH sh.a. për periudhën janar-dhjetor 2019, programin ditor, javor dhe mujor të kërkesës së konsumatorëve fundorë për energjinë elektrike në [mwh]

- Sa i takon objektin për shqyrtimin me ERE-n, lidhur me sasinë e energjisë elektrike parashikuar për t’u prodhuar dhe lëvruar nga KESH sh.a. për OSHEE sh.a. /FSHU, me qëllim garantimin e furnizimit për klientët fundorë, do jetë vetëm sasia totale vjetore 3,950,000 MWh dhe jo të dhënat e tjera të paraqitura në tabelat e aneksit 1 të kësaj kontrate

- Sasia e energjisë elektrike, për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë së prodhimit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, duke u bazuar në nivelin historik mesatar vjetor të dhjetë viteve të fundit, sipas informacionit të dhënë nga ERE dhe regjimit racional të shfrytëzimit të kapaciteteve gjeneruese.

- Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të KESH sh.a., në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë me vendimin nr. 14430/3, datë 19.12.2018 “Mbi miratimin e programit financiar të shoqërisë KESH sh.a. për vitin 2019” ka miratuar sasinë dhe çmimin e shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal në kuadër të detyrimit për shërbim publik.

- Nga shqyrtimi paraprak i draftit konstatojmë se:

- Palët kanë të drejtë të paraqesin për miratim në bordin e ERE-s këtë kontratë,

- Kontrata e paraqitur për miratim, është e dakordësuar dhe e nënshkruar nga të dyja palët,

- Kontrata ka dispozita të reja, krahasuar me kontratën në fuqi, shtyrë më vendimin e bordit të ERE nr. 16 datë, datë 18.2.2019,

- Palët duhet të japin shpjegime në lidhje me përputhshmërinë e kësaj kontrate me dispozitat e VKM nr. 244, datë 30.3.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”.

Për gjithë sa më sipër bordi i ERE-s:

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për miratimin e draftkontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal/OSHEE sh.a. për periudhën 1.3.2019–31.12.2019.

2. Shoqëritë KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. të paraqesin në ERE, relacion shpjegues në lidhje me dispozitat e reja të kësaj kontrate krahasuar me atë në fuqi, duke mbajtur në konsideratë, përputhshmërinë me VKM nr. 244/2016, ruajtjen e standardit të kontratave tip të miratuara nga ERE, si dhe qëndrimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë [MIE]

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë OSHEE sh.a., KESH sh.a., dhe MIE për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Aqmeti



NUMER 10, datë 10/2019

**MBI FILLIMI E PROJEKTOURËS PËR
NËNIN 9, PAKA 1, GERMA 2, 3, 4, 5
E PRIMITARINË E TREGUTIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k. në veprimtarinë e tregutit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Terna Energy Trading” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 302 prot., datë 17.4.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregutit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit nënenin 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, mm germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal nënenin 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregutit të energjisë elektrike nënenin 9, pika 4.8, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor, nenin 9, pika 2, germa “d” dhe “e” vërtetimi nga Prokuroria dhe Gjykata për përfshirje ose jo në një proces penal të drejtuesve të shoqërisë dhe Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit në përputhje me veprimtarinë për të cilën kërkohet licenca

Do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Terna Energy Trading” sh.p.k., në aktivitetin e tregutit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR
Petrit Ahmeti**



KOMISIJA

Shtatori 9, datë 10 Shtatori 2019

**MBI FILLIMI E PROJEKTOVËS, PËR
MOSHTËRITË E LIDHJES SË
SHOQËRISË HEZ ENERGY SHPK,
SERIA PV12K, TË MIRATUAR
ME QËNDIMIN E BORDIT TË
KOMISIONERËVE TË ERE-S RREGULLATOR,
ATË 2 Shtatori 2012, PËR LIDHJES QËNDIMIN E
SHOQËRISË HEZ ENERGY SHPK TË
AKTIVITETIT E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEZ-ET**

Në bazë të nenit 16 dhe nenit 43, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar në nenit 10, pika 3 dhe nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 në nenin 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë ERE në mbledhjen e tij të datës 10.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës, për modifikimin e licencës së shoqërisë HENZ ENERGY sh.p.k., me nr. 158, seria PV12K, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 65, datë 28.5.2012, për licencimin e shoqërisë HENZ ENERGY sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEZ-et “Darsi 1”, “Darsi 2”, “Darsi 3”,

konstatoi se:

- Shoqëria HENZ ENERGY sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 287, datë 10.4.2019, ka kërkuar modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.

- Shoqëria HENZ ENERGY sh.p.k., është mbajtëse e licencës me nr. 158, seria PV12K, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEZ-et “Darsi 1”, me kapacitet 2240 kW, “Darsi 2” me kapacitet 7633 kW, “Darsi 3” me kapacitet 1066 kW, me kapacitet total 10939 kW, dhënë me

vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 65, datë 28.5.2012, për një periudhë 30-vjeçare.

- AKBN-ja, me shkresën nr. 5821/5 prot., datë 16.8.2018, ka përcjellë në MIE “Raportin e oponencës teknike, mbi ndryshimet e projektit të zbatimit të HEC-eve “Darsi 1” dhe “Darsi 2”, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, MIE me shkresën nr. 8589/3, datë 16.8.2018 dhe kjo e fundit me shkresën nr. 8589/4 prot., datë 28.8.2018, drejtuar shoqërisë HENZ ENERGY sh.p.k., për dijeni AKBN-në, ka miratuar projektin e zbatimit përfundimtar të HEC-ve “Darsi 1” dhe “Darsi 2”.

- Kërkesa për modifikimin e licencës së sipërcituar vjen si rezultat i optimizimit të skemës hidroenergjetike, si dhe për përmirësimin e të gjithë parametrave duke pakësuar numrin e HEC-eve nga 3 në 2, me ndërtimin e objektit konkret (“Darsi 1” dhe “Darsi 2”) dhe rritjen e kapacitetit të instaluar respektivisht “Darsi 1”, me kapacitet të instaluar që rritet 3328 kW dhe “Darsi 2” me kapacitet të instaluar që rritet 11635 kW.

- Në vijim sa më sipër, shoqëria HENZ ENERGY sh.p.k. dhe MIE, kanë lidhur kontratën shtesë të koncesionit me nr. 2105 rep. dhe nr. 1120/3 kol., datë 28.9.2018 nr. 1120/3 kol., datë 28.9.2018 amendim kontrate koncesioni nr. 286 rep. dhe nr. 39 kol., datë 30.1.2009

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria HENZ ENERGY sh.p.k., në bazë të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, rezulton i plotësuar pjesërisht si më poshtë:

Formati dhe dokumentacioni për aplikim:

Neni 9, pika 1:

- germa “a” (të dhënat për aplikim), plotësuar;
- germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) plotësuar
- germa “c” (të dhëna për aplikuesin), plotësuar

neni 15 pika 4:

- germa “a”, një informacion me shkrim ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës, plotësuar.

- germa “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit të cilat shprehin



vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës, vendimi i datës 5.4.2019, plotësuar.

- germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera, plotësuar.

- germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimi të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi, plotësuar.

- germa “e”, të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE, plotësuar.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë HENZ ENERGY sh.p.k.,

Iqite:	“DARSI 1” me kapacitet të instaluar:	2240 kW
	“DARSI 2”, me kapacitet të instaluar:	7633 kW dhe
	“DARSI 3” me kapacitet të instaluar:	1.066 kW
	me kapacitet total të instaluar:	10.939 kW
Bëqet:	HEC “Darsi 1” me kapacitet të instaluar:	332
	HEC “Darsi 2” me kapacitet të instaluar:	113
	kapaciteti total i instaluar:	193

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

nr. 158, seria PV12K, të miratuar me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 65, datë 28.5.2012, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et: “Darsi 1” me kapacitet të instaluar 2240 kW; “Darsi 2”, me kapacitet të instaluar 7633 kW dhe “Darsi 3” me kapacitet të instaluar 1.066 kW, me kapacitet total të instaluar 10.939 kW.

2. Të shqyrtojë përmbushjen e kushteve dhe dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e ndryshimeve të licencës nr. 158, seria PV12K, në përputhje me parashikimet e kontratës shtesë të koncesionit nr. 2105 rep. dhe nr. 1120/3 kol., datë 28.9.2018, “Për ndryshimin e kontratës të formës “BOT”, për “Ndërtimin, operimin e transferimin e hidrocentraleve: “Darsi 1”, “Darsi 2” dhe “Darsi 3”, si më poshtë:

EEIM
rri1, datë 102019

MBI FILLIMI E PROE URËS PËR
1, 1, 0, 1 2, 32
1 23, 21 3
EPRIMTARI Ë E TRE TIMIT TË
ERJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në



mbledhjen e tij të datës 10.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Power and Gas Operations” sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Power and Gas Operations” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 308 prot., datë 23.4.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Power and Gas Operations” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikim, transferim, rinovim ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit nën 9, pika 1, germat “a”, “b” “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor nën 9, pika 2, germat “b”, “c”, “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal nën 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike nën 9, pika 4.8, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9, pika 2, germa “a” (akti i themelimit), germa “e” (Struktura e ndërtimit të shoqërisë. Lista e personelit sipas profilit në përputhje me veprimtarinë për të cilën kërkohet licenca

Do të njoftohet subjekti, që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Power and Gas Operations” sh.p.k., në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti

REMI

nr. 2, datë 10/2019

MBILITIMI I SHOQËRISË

00000301

VEPRIMTARI Ë E PROHIMIT TË

ENERGJISË ELEKTRIKE A

ENTRALI FOTOVOLTAIK, ME

KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, Ë

ZOË SHEQ MARIAS, JËSIA

AMISTRATIV E TOPOJË,

BASHKIA FIER

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, neneve 4, pika 1, germa “a”; neni 5, pika 1, germa “a”; neni 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, neni 15 i “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, në



zonën Sheq Marinas, njësi administrative Topojë, Bashkia Fier,

konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 50, datë 27.3.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, për një afat 25-vjeçar.

- Shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., është një subjekt përfaqësues në cilësinë e mbajtësit të miratimit përfundimtar me nr. 5864/11, datë 14.11.2018. Kjo shoqëri është e regjistruar pranë QKB-së, në datën 20.11.2017, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar [sh.p.k.] konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, me numër identifikimi (NUIS) L72320013B.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 822, datë 7.10.2015, “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike”, që nuk janë objekt koncesioni, i ndryshuar. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë i jep të drejtën e financimit, projektimit, ndërtimit e vënies në punë me kapacitet prodhues 2 mw.

- Objekt i veprimtarisë së “Smart Watt” sh.p.k., është ndër të tjera edhe kryerja e aktivitetit të importit, eksportit, tregimit, dhe furnizimit me shumicë dhe pakicë të energjisë elektrike si brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ndërtimin e impianteve të energjisë së rinovueshme, prodhimin e energjisë, studimin dhe konsulencën në aktivitetin e energjisë elektrike. Kryerja e çdo aktiviteti të lejuar nga legjislacioni për shoqëritë tregtare.

- Aplikimi i bërë nga shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik, për centralet solare (neni 9, pikat 4.4.1, 4.4.2, 4.4.3, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.4.4, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”; 4.5, gjerat “b”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Në lidhje me parashikimet e nenit 9, pika 4.5, gjerat “a” (miratimin e OST-së ose OSHEE-së, për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes), shoqëria ka aplikuar për marrjen e miratimit pranë OSHEE-së dhe kjo e fundit ka rekomanduar lidhjen në rrjetin e transmetimit.

- Në nenin 27, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, parashikohet se, operatorët e sistemit të transmetimit dhe shpërndarjes duhet të sigurojnë lidhjen me rrjetin e transmetimit dhe shpërndarjes mbi kushte jodiskriminuese.

- Sa më sipër, e drejta e çdo përdoruesi të rrjetit për akses në rrjetin e shpërndarjes apo të transmetimit është e garantuar me ligj.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Smart Watt” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me fuqi të instaluar 2 mw, në zonën Sheq Marinas, njësi administrative Topojë, Bashkia Fier për një afat 25-vjeçar.

2. Para vënies në punë të centralit, shoqëria “Smart Watt” sh.p.k., të depozitojë në ERE miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit apo shpërndarjes.

3. Drejtorja e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim, mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike dhe mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Aqmeti



REKORDI
 Nr. 10, datë 10.10.2019

0,0,0,0,1 0 9
**PËR SIGURIMIN E SHËRBIMIT TË
 SHPËRNDARJES SË ENERGJISË
 OSHEE SH.A. DHE KASTRATI ENERGY
 SHPK**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, nenit 20, pika 1, të marrëveshjes së sigurimit të shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike dhe Furnizuesit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, dhe ndryshuar me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e drejtorive teknike në lidhje me miratimin e marrëveshjes për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike nënshkruar midis shoqërisë OSHEE sh.a. dhe shoqërisë KASTRATI ENERGY sh.p.k.,

konstatoi se:

- Shoqëria OSHEE sh.a., me shkresën nr. 6586/3 prot., datë 15.4.2019, protokolluar me tonën me nr. 300 prot., datë 17.4.2019, ka dërguar në ERE marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike me nr. 6586/1 prot., datë 10.4.2019, të nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe KASTRATI ENERGY sh.p.k., me qëllim miratimin nga ERE të kësaj marrëveshjeje në zbatim të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017 “Mbi miratimin e marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe furnizuesit të energjisë elektrike”.

- Me vendimin nr. 39, datë 7.3.2019, bordi i ERE-s, ka licencuar shoqërinë KASTRATI ENERGY sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 96, datë 27.10.2014, të ndryshuar me vendimin nr. 216,

datë 11.10.2018 dhe me vendimin nr. 264, datë 20.12.2018 ka licencuar shoqërinë Operatori i Shpërndarjes të Energjisë Elektrike sh.a., në aktivitetin e shpërndarjes së energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

- Në marrëveshjen e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017, në nenin 20, pika 1, përcaktohet se: “Kjo marrëveshje hartohet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe, secila me vlerë të njëjtë ligjore, 2 për secilën palë dhe 1 për t’u dërguar për miratim në ERE”.

- Marrëveshja për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, e nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe KASTRATI ENERGY sh.p.k. ka reflektuar saktësisht të gjitha dispozitat që ERE ka parashikuar në marrëveshjen e miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 58, datë 15.4.2019, ka vendosur “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Furnizuesit”.

- Duke qenë se marrëveshja për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike e nënshkruar midis OSHEE sh.a. dhe KASTRATI ENERGY sh.p.k. mban datën 10.4.2019 dhe hyn në fuqi me miratimin nga ERE, ndryshimet e vendimit nr. 58, datë 15.4.2019 do të reflektohen në të.

- Me shkresën nr. 201 prot., datë 4.3.2019 të gjitha palët e interesit janë njoftuar edhe njëherë me përmbajtjen e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit, të propozuara nga OSHEE sh.a.

- Vendimi nr. 58, datë 15.4.2019, ka vendosur “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së energjisë elektrike OSHEE sh.a. dhe Furnizuesit dhe ka miratuar ndryshime në dispozitat e marrëveshjes tip, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 24, datë 15.2.2017.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë OSHEE sh.a. për “Miratimin e marrëveshjes për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike nr. 6586/1 prot., datë 10.04.2019 nënshkruar midis shoqërisë OSHEE sh.a. dhe shoqërisë KASTRATI ENERGY sh.p.k.”.

2. Ndryshimet e miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 58, datë 15.4.2019, “Mbi miratimin e disa ndryshimeve në marrëveshjen për sigurimin e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike ndërmjet Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE sh.a.) dhe Furnizuesit” do të zbatohen për të gjitha Marrëveshjet për Sigurimin e Shërbimit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike që janë lidhur dhe do të lidhen në vijim nga OSHEE sh.a. me Furnizuesit, pas hyrjes në fuqi të vendimit nr. 58, datë 15.4.2019, të Bordit të ERE-s.

3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë subjektet e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendrike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendrike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit A. Ahmeti

BEKIM
Rexhepi, datë 10 Prill 2019

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN PRILL 2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87, pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”,

miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017, i ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018 “Mbi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 10.5.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin prill 2019,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me anë të shkresës nr. 9438 prot., datë 25.4.2019, paraqiti në ERE aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin prill 2019 dhe kërkon që çmimi i shitjes së energjisë elektrike të klientët e FMF-së për muajin prill 2019 të jetë 13.67 lekë/kWh.

- Në informacionin e dërguar me anë të kësaj shkrese, për llogaritjen e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për klientët të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, është aplikuar formula për llogaritëse e parashikuar në nenin 8 të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, i ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018.

- Llogaritjet e OSHEE sh.a., si dhe propozimi i ERE për përcaktimin e çmimit për klientët që furnizohen nga FMF për muajin prill 2019 sipas “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit”, të rishikuar me vendimin nr. 144, datë 25.6.2018, paraqiten në tabelën përmbledhëse si vijon:



Çmimi për FMF për muajin prill 2019

Prill 2019		Aktiviteti i OSHEE	Prillimi i ERE
		Çmimi	Çmimi
a	Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	Lekë/kwh	9.35
b	Kthimi për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin 2019	Lekë/kwh	0.28
c	Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar	Lekë/kwh	9.35
d	Kostoja administrative e Furnizuesit të Mundësisë së Fundit	Lekë/kwh	1.79
e	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	Lekë/kwh	0.75
f	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	Lekë/kwh	1.5
Çmimi i energjisë së prodhuar		Lekë/kwh	13.67

- Nga informacioni bashkëlidhur aplikimit të “OSHEE” sh.a., mbi realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike, nga tregu i parregulluar rezulton se çmimi maksimal i blerjes është 74,87 EUR/mwh për sasinë 3,840 mwh nga shoqëria ofertuese EFT AG sh.p.k., në fazën përfundimtare të negociimit në datën 9.4.2019 për periudhën 11.4.2019–22.4.2019 dhe fashën orare 07:00–23:00.

- ERE, në datën 25.4.2019 zhvilloi një seance dëgjimore me shoqërinë OSHEE sh.a., për të diskutuar në lidhje me problematikat e zbatimit të “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit” në lidhje me përcaktimin e kursit zyrtar të këmbimit i ditës u dakordësua që do të jetë ai i ditës në të cilën mbyllet negociimi, udhëzim i cili i është përcjellë OSHEE sh.a. paraprakisht me anë të shkresë nr. 109/3 prot., datë 27.3.2019.

- Në lidhje me përcaktimin e kostove administrative OSHEE sh.a. vazhdon të mos ketë ndarje të llogarive midis aktiviteteve të Furnizimit dhe Shpërndarjes, si dhe nuk ka një strukturë të posaçme për evidentimin e kostove të administrimit për klientët e FMF-së. Në këto kushte është e arsyeshme të pranojmë koston për njësi prej 1,79 lekë/kwh, për përcaktimin e kostove administrative (elementi CA i formulës) të paraqitur nga OSHEE sh.a.

- Shoqëria OSHEE sh.a., vazhdon të mos përcaktojë kostot e disbalancave për klientët e FMF-së dhe nuk deklaron nëse i faturon këta klientë për këto kosto. Gjatë seancës dëgjimore OSHEE sh.a. u shpreh se do të vijojë përpjekjet

për zbatimin e këtij detyrimi ligjor për të matur dhe faturuar, kostot e disbalancave ndaj konsumatorëve FMF dhe do të informojë ERE për ecurinë e këtij procesi, për të cilin ka nisur një korrespondencë me OST sh.a. duke i kërkuar një program orar ku të evidentohen diferencat midis programit dhe konsumit faktik.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit: bazuar në vendimin nr. 266, datë 21.12.2018, të bordit të ERE-s “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria OST sh.a. për vitin 2019” është 0.75 lekë/kwh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV: bazuar në vendimin nr. 268, datë 21.12.2018 të bordit të ERE-s “Mbi lënien në fuqi të vendimit të bordit të ERE-s nr. 190 datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019” është 1.5 lekë/kwh.

- Në përfundim, nga verifikimi i informacionit dhe përlllogaritjeve të paraqitura nga shoqëria rezulton se çmimi për shitjen e energjisë elektrike për klientët në kushtet e FMF-së për muajin prill 2019 është 13.67 lekë/kwh.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga



Furnizuesi i Mundësisë së Fundit prej 13.67 lekë/kWh për muajin prill 2019.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

q E q IM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier me vendimin nr. 62-2019-2369[578] datë 2.5.2019, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetases Farije Tafa, e datëlindjes 26.1.1964, nga data 1.11.1981, si dhe caktimin në cilësinë e kujdestarit për administrimin e pasurisë së saj, vëllain e saj, shtetasin Mikel Tafa, i datëlindjes 29.1.1972.

q E q IM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë, me vendimin nr. 12-2019-899/245, datë 9.5.2019, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Ilir Gosa, i datëlindjes 25.6.1971, nga data 20.3.1994.

q E q IM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr. 466[1978] datë 17.4.2019, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Byrhan Shaqir Katana, i datëlindjes 12.12.1947 dhe vendosjen e tij nën kujdestarinë ligjore të kërkuesve Rudina Katana dhe Imir Katana.

KËRKESË

Shtetasi Shaip Tota, i datëlindjes 21.3.1953, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, shpalljen të zhdukur të vajzës së tij, shtetases Rajmonda Tota, e datëlindjes 11.6.1990.

KRKUES
Sai Tota

[Shqiptarja.com]

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 392 lekë